

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7696 E enjte 1 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Njëqind vjetë të shkuara, deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore, gjuha shqipe e shkollave dhe mësimi u lërvua dhe erdhi në mëmëdhe vetëm ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDON ANDONI

Shqipja në diasporë,
pas një shekulli



Opinion **i** Ditës

Lobistët amerikanë të paguar nga Arabia Saudite dhanë më shumë se 2.3 milionë dollarë për fushatat politike amerikane në fund të vitit 2016 dhe ...
Vijon në faqen 21

Nga ZËRI I AMERIKËS

Arabia Saudite, miliona USD për të ndikuar në Kongresin Amerikan



Operacioni "Ballkan", linja e trafikut

Heroina nga Turqia, 10 vjet burg për biznesmenin, ja denimet për 8 të tjerë

Gjykata e Krimeve të Rënda pranoi gjykim të shkurtuar. Kush janë turqit që garantonin furnizimin

TIRANË. Gjykata e Krimeve të Rënda dje ka dhënë vendimin për anëtarët e bandës së biznesmenit Jurgen Molla, të cilët u vunë në pranga dy vite më parë. Në vendimin e saj, gjykata vlerësoi akuzat e dosjes së prokurorisë dhe vendosi dënimin me 15 vite burgim për Jurgen Mollën, që njihet se anëtar kryesor i grupit. Ndërkohë që Molla ...
Në faqen 9

HISTORIA/ 5 SHQIPTARE TË VRARË NGA POLICIA APO GARDIANET GREKE NE 5 VJETE

VRASJA E GREKUT, HETIMI: RENEA NUK SHKELI LIGJIN

Raporti paraprak i policisë: Neutralizimi i Kaçifas, u zbatua procedura. Djegia e flamurit shqiptar, MPJ thërret ambasadorin greke në Tiranë



(Në foto) Protesta e djeshme në Selanik. Konstandin Kaçifas

Në faqen 2-3

AKUZAT

PD: Shpërbleve kriminelët. Dako: Gjyqi i ndan këto muhabetë

Në faqen 6

LOKALET

Zgjedhjet më 23 apo 30 qershor? Meta konsultohet me partitë politike

Në faqen 5

SHKODER

Goditet grupi që trafikonte sirianë nga Mali i Zi drejt Europës

Në faqen 8

FLET AKTORI

Arben Derhemi: "Turbina", pallat sporti jo skenë teatri, keqardhje

Në faqen 18

FLET PROFESORI ANGLEZ



Emigracioni potencial, Shqipëria e para në Europë, e pesta në botë

Në faqen 17

Gramoz Ruçi: Mundësi praktike për studentët. Vlerë e shtuar për vendin

23 universitete, marreveshje me Kuvendin

Rektori i "Luarasit", Et'hem Ruka: Bashkëpunimi, përfitim për të gjithë

NGA VOLTIZA DURO

Ditën e djeshme, Kuvendi i Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me 23 universitete publike e private në vend si dhe me Akademinë e Shkencave. Kjo marrëveshje synon që institucionet e ar-



simit të lartë në vend, të jenë aktorë të fuqishëm në procesin legjislativ dhe kontrollin parlamentar. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, theksoi se përfshirja e universiteteve në ligjëligjërbërje mund të shndërrohet në një vlerë të shtuar për vendin ...

Në faqen 11

SHQIPERI-GREQI MARREDHENIET

Pëllumb Marknikollaj u vra në komisariatit e policisë, familja e gjeti në varreza

Nga dy vëllezërit peshkatarë të Ilija Kareli, si na vranë grekët ndër vite

Rastet e dyshimta kur dhuna shkaktoi 5 viktima

Duke u treguar një shet serioz që respekt ton qytetarin e vet, Greqia ka artikulluar reagime të përditshme ndaj palës shqiptare për vrasjen e Kostandinos Kaçifas nga forcat speciale RENE A. Qeveria greke ka protestuar pranë MPJ-së dhe ka thirrur për shpjegime ambasadorin tonë në Athinë: më tej ka kërkuar që hetimi të jetë dypalësh.

Nga ana tjetër, mjaft qytetarë shqiptarë kanë humbur jetën ndër vite, ose të vrarë në kufi, ose në paraburgimet greke, ose të torturuar në burgje. Në të gjitha rastet, reagimi zyrtar i Shqipërisë ka qenë anemik. "GSH" po përmbledh incidentet e fundit ku qytetarë shqiptarë kanë humbur jetën nga forca të sigurisë greke. Rasti i Kudret Kumes (emri i ndryshuar: Ilija Kareli), i cili vdiq nga torturat në burg dhe i Pëllumb Marknikollaj që vdiq nga torturat në komisariatit dhe pastaj u fshih në varreza pa identitet, janë vetëm 2 raste të dyshimta që vërtetojnë se jo pak shqiptarë kanë lënë kokat në vendin e Sokratis.

KORRIK 2013

Policia greke ekzekutoi shqiptarin, Marian Kola, të arratisur nga burgu i Trikallës. Ngjarja ndodhi në vendin e quajtur Vrosina, 15 kilometra nga kufiri shqiptaro-grek, në Thesproti. Së bashku me Ilir Kupën ai ishte arratisur nga burgu dhe sipas mediave greke ata patën një shkëmbim zjarri me forcat e sigurisë së vendit fqinj.

DHJETOR 2013

Policia greke vrau në Follorinë dy vëllezërit shqiptarë Melsi dhe Klevis Çollaku, sepse këta të fundit qëlluan mbi një polic grek. Ata u ekzekutuan në vendngjarje, në një kasolle në tokën greke. Por sipas familjarëve dy djemtet kishin shkruar për peshkim.

Sipas policisë greke ishte një rast flagrant i qytetarëve shqiptarë me armë kundër



policisë dhe ata u vranë nga pala greke.

Në dhjetor të 2013, familjarët në Shqipëri kërkuar ekspertizë dhe e bënë atë privatisht. Por pas përfundimit të gjyqimit në Greqi, institucionet shqiptare nuk reagojnë aspak mbi këtë çështje. Megjithatë dy shtetas u vranë në kushte nëdoshta të diskutueshme sipas familjarëve.

Familjarët dyshuan se ata u ekzekutuan nga policia greke dhe thanë se dy djemtet nuk ishin të armatosur.

MARS 2014

Me syrin e nxirë dhe plagë në qafë, para se të vdiste i burgosuri shqiptar, Ilija Kareli (Kudret Kume) u tha gardianëve grekë se "Dua vetëm të pushoj pak, jam shumë i lodhur". Një infermiere në burg pati thënë se "nuk ka rëndësi shëndeti i tij", ndërsa një gardian, pas rrahjes disaorësh, e kishte pyetur se për çfarë kishte nevojë. Këto janë mësuar nga dëshmitë e 3 gardianëve grekë, në Gjykatën e Selanikut, gjatë procesit gjyqësor ndaj 14 punonjësve të burgjeve, të akuzuar për vdekjen e shqiptarit. Mes të

5 VRASJET E SHQIPTAREVE NGA FORCAT E SIGURISE NE GREKI

- **Korrik 2013** - Policia greke ekzekutoi shqiptarin Marian Kola, i arratisur nga burgu i Trikallës.
- **Dhjetor 2013** - Policia greke vret në Follorinë dy vëllezërit shqiptarë Melsi dhe Klevis Çollaku.
- **Mars 2014** - Vritet pas torturave në qelinë e burgut të Nigritës, Ilija Kareli (emri i vërtetë: Kudret Kume)
- **Gusht 2016** - Vritet në komisariatit e policisë së Athinës, Pëllumb Marknikollaj pasi kishte shkruar për "detyrim paraqitjeje".

akuzuuarve ishte edhe drejtori i një burgu. Përveçse me grushte e shkelma, marsin e vitit 2014, Kareli u rrah nga shkopi gjome, iu vu tel elektrik në trup gjersa iu dëmtua zemra, u qëllua me leckë të lagur dhe ndaj tij u praktikuan arte marciale nga gardianët, gjersa dha shpirt

në shtratin e burgut të Nigritës në Greqi. Kareli ishte akuzuar për vrasjen e një gardiani grek në një burg tjetër.

GUSHT 2016

Viktima Pëllumb Marknikollaj jetonte si emigrant në Greqi. Ai ishte arrestuar për vjedhje, duke bërë 8 vite

Mjaft qytetarë shqiptarë kanë humbur jetën ndër vite, ose të vrarë në kufi, ose në paraburgimet greke, ose të torturuar në burgje. Në të gjitha rastet, reagimi zyrtar i Shqipërisë ka qenë anemik. "GSH" po përmbledh incidentet e fundit ku qytetarë shqiptarë kanë humbur jetën nga forca të sigurisë greke.



EDI RAMA: KAÇIFA, I FANDAKSUR

"Fqinj të dashur! Në vend ta qani të papranueshme humbjen e jetës së një të fandaksuri që qëlloi me plumba luftarakë mbi policinë tonë, e cila bëri vetëm detyrën e saj, bashkohuni me ne në falënderimin e Zotit që asnjë jetë e pafajshme nuk humbi sot nga marrëzja ekstremiste", shkroi Edi Rama në "Twitter" ditën e ngjarjes.

burg. Prej 4 muajsh gjykata e kishte liruar duke i dhënë një mase më lehtësuese, detyrim paraqitjeje. Me datë 3 gusht në orën 20:00 të mbrëmjes, shqiptari është paraqitur në rajon, por nuk ka dalë më i gjallë nga aty. Policia e ka dërguar të vdekur në morgun e spitalit "Erithros Stravros" Athinë, duke deklaruar se i riu shqiptar ka rënë nga kati i katërt i godinës së rajonit. Rastësia ka bërë që pak minuta para se të futej në rajon, Pëllumb Marknikollaj të telefononte një shokun e tij. Gjatë bisedës i ka thënë se do ta ritefononte pasi të firmoste paraqitjen në rajonin e policisë. Miku i 28-vjeçarit ka pritur telefonatën që nuk ka ardhur më.

Pasi i riu nuk është bërë i gjallë, miq dhe familjarë janë interesuar për humbjen e kontakteve të tij. Avokati, i cili ndiqte çështjen penale të Pëllumb Marknikollaj, ka refuzuar të flasë me shokët e të ndjerit, duke thënë se ishte me pushime. E gjithë kjo situatë e paqartë ka vënë në alarm familjarët e të riut nga Lezha, ndërsa vëllai i tij ka udhëtuar drejt Athinës në kërkim të gjurmëve të vëllait të zhdukur. Pas shumë kërkimeve dhe përmes një avokateje është gjetur trupi i të riut fatkeq në frigoriferin i varrezave "Agio Anargiuro", gati për

t'u varrosur duke u klasifikuar si një kufomë pa identitet.

Fillimisht drejtuesit e varrezave kanë refuzuar të tregojnë trupin, të cilit i ishte bërë autopsia pa praninë e prokurorisë, grupit hetimor, familjarëve apo avokatit, por vetëm me urdhër të policisë greke. Miqtë e tij rrëfejnë për "Realiteti News" se trupi ka pasur shenja të dukshme të një dhune monstruoze. Pasi drejtuesit e varrezave janë ballafaquar me familjarët dhe miqtë, ato kanë thënë se trupi është sjelle i vdekur dhe ai do i dorëzohej familjarëve me kushtin e vetëm, që të mos kishte denoncime dhe çështja të varrosej bashkë me të.

Familjarët në gjendje shoku kanë tërhequr kufomën e të riut nga dhoma frigoriferike e varrezave. Trupi mbërriti në Shqipëri, ndërsa në familjen Marknikollaj në Rrilë të Lezhës janë hapur dyert e mortit.

Kanë qenë miqtë e viktimit, të cilët kanë shkruar në rajonin e policisë duke kërkuar pamjet filmike të hyrjes dhe daljes së shqiptarit, pamje të cilat janë të zhdukura nga çdo server.

Ata kërkuar nga Ministria e Jashtme e vendit tonë dhe ambasada shqiptare në Greqi që rrethanat e vdekjes të Pëllumb Marknikollaj të zbardhen.



SHÇBA nxjerr raportin paraprak, Kaçifa qëlloi 30 minuta mbi policinë

Vrasja e ekstremistit grek, hetimi: RENEA zbatoi ligjin

Neutralizimi i 35-vjeçarit sipas procedurës

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme ka nxjerrë një raport paraprak për vrasjen e Konstandin Kaçifës në Bularat, ku thuhet se Forcat RENEA zbatuan ligjin.

Ky është konkluzioni paraprak i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme për ngjarjen e së dielës. Në të njëjtën përfundim ka dalë edhe drejtorja e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, që thekson se Kaçifa u ekzekutua pas disa thirrjeve për dorëzim nga reparti special RENEA.

Sipas dinamikës së zbardhur për ngjarjen, mësohet se viktima ka hapur zjarr me breshëri automatiku jo vetëm ndaj mjeteve dhe forcave elite të policisë së shtetit edhe ndaj forcave "Shqiponja" të policisë së Gjyroskastrës, të cilat erdhën në ndihmë, përpara se të mbërrinte RENEA nga kryeqyteti. Në vendngjarje forcat speciale kanë bërë kontrollin e terrenit për vlerësimin e situatës, si dhe një plan operacional për lokalizimin dhe neutralizimin e 35-vjeçarit. Por, megjithëse u lokalizua, Kaçifa për 30 minuta nuk iu bind thirrjeve për dorëzim të negociatorit të RENEA-s duke hapur sërish zjarr ndaj efektivëve të policisë. Pranë deponës së ujit në Bularat u gjeten 31 gëzhoja automatike.

Gjithashtu, janë analizuar edhe pamjet filmike që RENEA-s kishin regjistruar gjatë aksionit në Bularat. Këto materiale filmike regjistrohen sipas protokollit nga forcat speciale në të tilla ngjarje me rrezik të lartë, dhe në rastin konkret hedhin poshtë çdo pretendim për veprim të njëanshëm në drejtim të Konstandinos Kaçifas.

Sipas dinamikës së zbardhur për ngjarjen, mësohet se viktima, përveç Policisë Rrugore, ka hapur zjarr me breshëri automatiku edhe ndaj forcave "Shqiponja" të policisë së Gjyroskastrës, të cilat erdhën në ndihmë përpara se të mbërrinte RENEA. Po ashtu, mësohet se në vendngjarje forcat speciale kanë bërë fillimisht rikognicionin e zonës, e thënë ndryshe kontrollin e terrenit, për vlerë-



Konstandin Kaçifa

U qëllua pas 2 orëve operacion në mal

Ekspertiza e thelluar, grup me katër mjeko-ligjorë, asnjë grek

4 ekspertë të Institutit të Mjekësisë Ligjore janë përfshirë në ekspertizën që po zhvillohet për vrasjen e Konstandinos Kaçifas, 35 vjeç. Por, ndërkohe ekspertët janë në pritje edhe të pyetjeve dhe rezervave të familjarëve të viktimës.

Është qëlluar apo jo nga afër nga forcat RENEA Konstandinos Kaçifa? Kjo është pyetja e parë të cilës ekspertët e mjekësisë qendrore do t'i japin përgjigje përfundimtare, një konkluzion që do t'i bashkëngjitet kartelës së vdekjes, por edhe fashikullit hetimor të Krimeve të Rëndës. E gjithë kjo procedurë po zhvillohet për shkak të pretendimeve të familjarëve të Konstandinos Kaçifas, pavarësisht se menjëherë pas vrasjes së tij gjatë shkëmbimit me armë zjarri me policinë, reparti RENEA i ka dorëzuar prokurorisë të gjithë procedurën se si u zhvillua



aksioni. Në raport-shërbim thuhet se Kaçifa ka qëlluar me armën automatikë për gjatë dy orëve operacion, duke rrezikuar jetën e oficerëve dhe gjatë shkëmbimit me armë zjarri ai është qëlluar nga policia nga një distancë e konsiderueshme. Por, tashmë që trupi i tij është sjellë në morgun e Tiranës, nëse të afërmit e Konstandinos Kaçifas kanë pretendime apo pyetje shtesë,

EKSPERTIZA PËR 10 DITË
Aktualisht, ekspertët e mjekësisë ligjore po vlerësojnë edhe të dhënat e domosdoshme për një ekspertizë të dërguar nga ekspertët e kriminalistikës pas këqyrjes së kuфомës në Gjyroskastrë. Një procedurë ekzaminimi zgjat 3 deri në 4 javë, por grupi i ekspertëve parashikon ta përfundojë procesin brenda 10 ditëve.

ata mund t'i dorëzojnë materialet pranë mjekësisë ligjore ose personalisht ose përmes një avokati, tha për Top Channel një nga zyrtarët e mjekësisë ligjore. Në grupin e mjekëve ligjorë shqiptarë nuk ka asnjë ekspert të huaj, jo vetëm sepse nuk ka një kërkesë të tillë zyrtare pranë organeve të hetimit, por edhe sepse ligji nuk e lejon diçka të tillë.

Sipas burimeve, për të hedhur poshtë çdo pretendim mbi veprimet e policisë ditën e ngjarjes, RENEA duhet të zotërojë edhe një material filmik, që parashikohet në protokollin e ndërhyrjes nga forcat speciale në të tilla ngjarje me risk të lartë.

KAÇIFA E PARALAJMEROI AKTIN

Në videon e publikuar nga mediat, shihet se Kaçifa mban në dorë një kallash të modifikuar me 3 krehër të bashkuar, i veshur me uniformë ushtarake. Kjo të bën të mendosh se viktima që u vra nga RENEA e kishte paramenduar aktin e tij të goditjes së policisë shqiptare.

EKSTREMISTET



Protestë me gjuhë raciste në Selanik: Duam "Vorio Epirin"

Vrasja e minoritarit grek, Kostandinos Kaçifas, është shoqëruar me tone të ngritur të politikës shqiptare, por edhe asaj greke. Kjo ngjarje ka ndezur gjuhën raciste në Greqi. Qytetarët grekë, kryesisht ato që vijnë nga radhët e Agimit të Artë kanë protestuar në rrugët e Athinës, por edhe para ambasadës shqiptare atje. Me pankarta në duar dhe teksta kërkojnë drejtësi për Kaçifasin, qytetarët grekë sot janë mbledhur sërish në Selanik duke brohoritur dhe duke mbajtur parulla, të cilat etiketojnë shqiptarët në forma të ndryshme.

“
PROTESTAT
Qytetarët grekë, kryesisht ato që vijnë nga radhët e Agimit të Artë kanë protestuar në rrugët e Athinës, por edhe para ambasadës shqiptare atje. Me pankarta në duar dhe teksta kërkojnë drejtësi për Kaçifasin, qytetarët grekë sot janë mbledhur sërish në Selanik duke brohoritur dhe duke mbajtur parulla, të cilat etiketojnë shqiptarët në forma të ndryshme.

Sic raportojnë mediat greke, protestuesit shkuar në drejtim të konsullatës shqiptare në Selanik. Protesta e tyre ishte njoftuar më parë, ndërsa sot ata të gjithë njëzëri kërkojnë që të hetohet ngjarja e rëndë, ku mbeti i vrarë minoritari grek pas një shkëmbimi me armë zjarri me forcat RENEA.

NGJARJA NE BULARAT REAGIMET

Zv.ministri i Jashtëm grek telefonon Bushatin: Të zbardhet vrasja e Kaçifas

Valentina Madani

Qeveria shqiptare i kërkon Athinës të distancohet e të dënojë aktet e rënda të ndodhura në Greqi dhe që cenojnë klimën e marrëdhënieve miqësore mes fqinjëve. Këtë mesazh i përcollti dje Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ambasadores greke në Shqipëri, Eleni Surani, e thirrur për të dytën ditë radhazi pranë selisë së diplomacisë shqiptare. Këtë herë në lidhje me ngjarjet e ndodhura në Greqi, duke nisur nga alarmi për bombë pranë ambasadës sonë në Athinë, djegia e bizneseve shqiptare, protesta para ambasadës dhe konsullatës tonë, si dhe djegia e flamurit kombëtar. Në takim, ambasadores Surani i është nënvizuar nevoja që autoritetet greke të marrin masat e duhura për të garantuar jetën dhe pronën e shtetasve shqiptarë me banim në Greqi. "Ambasadorja e Greqisë në Shqipëri, Eleni Surani u thirrur sot (dje) në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në lidhje me ngjarjet e ndodhura në Greqi, duke nisur nga alarmi për bombë pranë ambasadës sonë në Athinë, djegia e bizneseve shqiptarë, protesta para ambasadës dhe konsullatës sonë si dhe djegia e flamurit kombëtar. Ambasadores iu kërkua distancimi dhe në të njëjtën kohë dënimi nga ana e autoriteteve greke ndaj këtyre akteve të rënda, që cenojnë klimën e marrëdhënieve miqësore mes fqinjëve. MEPJ nënvizoi gjithashtu nevojën që autoritetet greke të marrin masat e duhura për të garantuar jetën dhe pronën e shtetasve shqiptarë me banim në Greqi", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Jashtme. Ngjarjet e fundit në Greqi vijnë pas vrasjes në Bularat të minoritarit Konstandinos Kacifas. Edhe dy ditë më parë ambasadorja e Greqisë në Shqipëri, Eleni Surani u thirr në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ngjarjen e ndodhur në Bularat, Gjirokastër. Ndërkohë që dje zv.ministri i Jashtëm grek, Georgios Kastroulas, dje telefonoi ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati duke i kërkuar zbardhjen e ngjarjes për vrasjen e 35-vjeçarit Konstandinos Kacifas. "I theksova nevojën e bashkëpunimit, me respekt në pavarësinë e drejtësisë së të dyja palëve", deklaroi z.Kastroulas. Deklaratat e numrit dy të diplomacisë greke u bënë gjatë një interviste në radion greke "Real FM", i cili theksoi se, "hetimet nga Athina kanë nisur në bazë të nenit 7 të Kodit Penal, që lejon hetimet paralele kur kemi veprë penale ndaj një qytetari grek".

Sulmet ndaj shqiptarëve, Ministria e Jashtme-ambasadores greke: Distancohuni

"Kujdes, mos cenoni shtetasit tanë në Greqi"



Ministria e Jashtme

Alarm në ambasadën shqiptare në Athinë: Ju kemi vënë bombë

Alarm për bombë dje në ambasadën shqiptare në Athinë. Paraditen e djeshme në ambasadën shqiptare në Athinë ka pasur një telefonatë për bombë. Telefonata ka qenë vetëm 7 sekonda, ndërsa autori ka thënë "Ju kemi vënë bombë". Kaq mjaftoi që stafi i ambasadës shqiptare në Athinë të evakuohet menjëherë. Burime diplomatike nga Athina bëjnë me dije se menjëherë ambasada ka njoftuar policinë, e cila ka rrethuar me perimetër sigurie të gjithë zonën. Kontrolli policor i policisë greke ka zgjatur rreth një orë dhe ka qenë i shtrirë në ambientet e jashtme dhe brenda godinës së ambasadës. Autoritetet greke pas kontrollit disa orë nuk kanë gjetur asgjë dhe alarmi ka rezultuar falas. Ndërkohë që mediati grek e tjetërsuan alarmin për bombë duke e referuar pranë Gjykatës së Lartë të Greqisë. Përballë kësaj situatë, Ministria e Jashtme shqiptare ka thirrur menjëherë ambasadores e Greqisë në Tiranë, 24 orë pasi ajo u thirr për çështjen e Konstandinos Katsifas. Rritja e tensioneve mes Shqipërisë dhe Greqisë nisi pas vrasjes së minoritarit në Gjirokastër. Ekstremistët grekë organizuan disa protesta para ambasadës dhe konsullatës shqiptare, i vendosën zjarin një biznesi me pronar shqiptar në Athinë dhe mbrëmë dogjën edhe flamurin kuqezit.



Shoqëria përparimore JUSTITIA

Shoqëria përparimore JUSTITIA shpall ankandin, faza III, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:
 Trulli- Ndërtues me sip. totale prej 250 m², nga ku trulli 250 m², dhe ndërtesë 101 m², nr. pasurie 9/383, Vol. 16/fq. 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. "Sheq i Madh" Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi
 Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.276.000 (tri milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë
 Ankand i zhvillohet në datën 30.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270899

Sulmi



KERKESA


MEPJ bën me dije se ambasadores Eleni Surani iu kërkua distancimi dhe dënimi nga ana e autoriteteve greke ndaj këtyre akteve të rënda që cenojnë klimën e marrëdhënieve miqësore mes dy vendeve. Gjithashtu, Tirana zyrtare kërkon nga Athina të marrë masat për të garantuar jetën dhe pronën e shtetasve shqiptarë në Greqi.



Banderola "një grek më pak, një bastard më pak"

Distancohet nga parulla Olsi Rama: Ekstremistët nuk kanë vend te ne

Drejtori i klubit "Partizani", Olsi Rama, foli dje për me diat greke pas banderolës së vendosur në ndeshjen Partizani-Skënderbeu "një grek më pak, një bastard më pak". Në një prononcim për "gazzeta.gr", z.Olsi Rama deklaroi se banderola nuk është vendosur nga tifozët e Partizanit dhe se nëse fajtorët do ishin identifikuar, qëndrimi i klubit do ishte i menjëhershëm. Rama deklaroi se po punohet për të zbardhur ngjarjen dhe për të gjetur fajtorët. "Pozicionimi i klubit nëpërmjet komunikatës ka sqaruar fjalët që dua të them. Sapo e pamë atë banderolë në tribuna, fola me policinë dhe me stafin tonë që ta hiqnin atë parullë. Qëndroi e hapur për shumë pak minuta. Është e qartë që incidentet të tilla duhet të na bëjnë më të alarmuar. Qëllimi ynë është të luajmë futboll dhe çdo gjë tjetër jashtë fushave nuk ka lidhje me ne. Për fat të keq nuk kemi kamera sigurie për të lokalizuar ata që e hapën. Kërkuam, pyetëm, por ultrasit tanë e mohuan të kishin lidhje me atë rast. Ai që e ka bërë, me siguri e ka bërë për të shkaktuar ndonjë problem, por e kuptojmë që është në pakicë dhe nuk ka vend në fushën tonë. Ju siguroj se nëse do i dinim fajtorët, do kishim vepruar në një mënyrë tjetër. Nacionalistë dhe ekstremistë të tillë nuk kanë vend tek ne. Ata nuk përfaqësojnë qëndrimin tonë dhe në bashkëpunim me autoritetet po mundohemi nëse ka ndonjë mënyrë për të gjetur ata që e bënë", deklaroi z.Rama. Një banderolë ku shkruhej "Një grek më pak, një bastard më pak" është ngritur të hënën në stadiumin "Selman Stërmasi" për gjatë ndeshjes Partizani-Skënderbeu. Parulla në fjalë ka shkaktuar një sërë reagimesh, qoftë nga pala shqiptare e qoftë nga ajo greke, por së fundmi ka reaguar Federata Shqiptare e Futbollit. FSHF-ja e ka cilësuar banderolën me sfond racist dhe të papranueshme për fushën e blertë.



Gjate një seance parlamentare



Vrasja e Kaçifas, Tavio: Pseudopatriotët s'dinë ku bie Bularati

Deputeti i LSI në qarkun e Gjirokastër, Vangjel Tavo reagoi dje pas vrasjes së minoritarit Konstandinos Kacifas në Bularat të Gjirokastër. Tavo shkruan në "FB" se patriotë e pseudopatriotë po bëjnë të kundërtën e asaj që duhet bërë në rast të tilla. "Pas vrasjes së minoritarit Konstandinos Kacifas në Bularat të Gjirokastër, opinionioni publik, debatet në studio televizive, media e portale të ndryshme, analistë të njohur e të panjohur, patriotë e pseudopatriotë, duket se po bëjnë të kundërtën e asaj që duhet bërë në rast të tilla: në vend që ruajmë qetësinë, ne po e humbasim atë, e në vend që të apelojmë të gjithë së bashku për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe transparencë të nivelit të lartë të asaj çfarë ka ndodhur në të vërtetë, gishtat drejtohen kuturu nga të dyja anët e kufijve, fajtorit gjendet vetëm në një të klikuar të telekomandës, apo me një status në "Facebook" nga ndonjë cep geografik pa ditur se nga bie Bularati", tha z.Tavo.



"Lokalet", Spaho: Do hyjmë në zgjedhje, por me kusht që të garantohet vota e lirë

Zgjedhjet më 23 apo 30 qershor? Meta konsultohet me partitë politike

Balla: Sezoni zgjedhor, prill-maj-qershor

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta nisi dje konsultimet me krerët e grupeve parlamentare të partive kryesore PS, PD dhe LSI për caktimin e datës së zgjedhjeve të ardhshme lokale. Taulant Balla, Edmond Spaho dhe Luan Rama u pritën në takime të veçanta nga kreu i shtetit. Presidenti duhet të vendosë për një datë për mbajtjen e zgjedhjeve lokale 9 muaj përpara mbajtjes së tyre, që në Kod përcaktohet se duhet të zhvillohen nga data 15 mars deri më 30 qershor. Zgjedhjet e fundit lokale 4 vite më parë u zhvilluan në 21 qershor dhe data më e mundshme për t'u mbajtur zgjedhjet e ardhshme është mes dy të dielave të fundit të qershorit. Mësohet se operatorët turistikë i kanë kërkuar presidentit që të vlerësojë mundësinë që zgjedhjet të mbahen në një datë që nuk dëmton sezonin turistik, siç ka ndodhur në proceset e fundit zgjedhore. Tanimë pritet fjala e kreu të shtetit. Pikërisht për të caktuar një datë të pranueshme nga të gjitha palët politike, z. Meta nisi dje konsultimet. Plot 30 minuta pas daljes nga Presidencia, Balla duke e falënderuar Metën për vijimin e kësaj tradite të krijuar ndër vite tha se Kodi Zgjedhor e përcaktonte qartë se zgjedhjet mund të mbahen të dielën e parafundit ose të fundit të qershorit, pra 23 ose 30 qershor. "Por - shtoi ai - diskutimi është përqendruar në një propozim të operatorëve turistikë, të cilët kanë kërkuar një datë më të hershme se fundqershori. "Duke e falënderuar presidentin për vijimësinë e një tradite shumëvjeçare. Kodi Zgjedhor është i qartë në përcaktimin e sezonit zgjedhor prill-maj-qershor, duke përcaktuar dy të dielat e fundit të qershorit si dy data të mundshme të zhvillimit të zgjedhjeve vendore. Ka pasur nga operatorët turistikë një kërkesë të kahershme për një datë më herët se fundqershori, por sigurisht kjo është një çështje që i takon dakordësisë mes të gjithëve. Presidenti i Republikës do të bëjë këtë proces konsultash dhe shumë shpejt do të kemi datën. Ne nuk propozojmë datë, sepse datën e përcaktonte presidenti dhe Kodi Zgjedhor", theksoi kreu i deputetëve të PS-së. Pas Ballës, Meta zhvilloi konsultime me kreu e grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho. Ky i fundit nuk foli për mediat. Por në studion e "News




Presidenti Ilir Meta

KËRKESA

Mësohet se operatorët turistikë i kanë kërkuar Presidentit Ilir Meta që të vlerësojë mundësinë që zgjedhjet të mbahen në një datë që nuk dëmton sezonin turistik, siç ka ndodhur në proceset e fundit zgjedhore. Tanimë pritet fjala e kreu të shtetit.

Mbështetja, Kryemadhi: Nxitje bashkëpunimit Shqipëri-Kinë

Gjatë vizitës zyrtare në Republikën Popullore të Kinës, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi zhvilloi një takim në Asamblesë Kombëtare Popullore me z. Hu Ke Ming, anëtar i grupit të miqësisë Kinë-Shqipëri. Kryemadhi falënderoi Hu për mikpritjen dhe shprehur angazhim të emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, për të nxitur më tej bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve, duke i vendosur një theks të veçantë projekteve të zhvillimit në kuadër të nismës "Një brez një rrugë", si dhe për forcimin e bashkëpunimit në një sërë fushash të tjera



prioritare. Hu ndau me delegacionin e LSI-së vlerësimet e një bashkëpunimi të gjatë dhe konstruktiv ndërmjet dy vendeve dhe theksoi edhe njëherë vullnetin për t'i nxitur këto marrëdhënie më tej nëpërmjet bashkëpunimit mes Asamblesë Popullore dhe Kuvendit të Shqipërisë. Pasi vlerësoi rolin e LSI si

pjesë e Parlamentit të Shqipërisë dhe deputetëve të saj, pjesë e grupit të miqësisë "Shqipëri-Kinë", ndau disa fusha prioritare të bashkëpunimit si investimet, sipërmarrja dhe shkëmbimet arsimore e kulturore nëpërmjet Institutit "Konfuciu". Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi përkrahu vazhdimin e shkëmbimeve ndërmjet 2 parlamenteve dhe grupeve të miqësisë. Ajo theksoi mundësitë e reja të bashkëpunimit që janë hapur në kuadër të iniciativës "Një Brez, Një Rrugë dhe Platformës 16+1", si dhe fushave të tjera konkrete si bujqësia e turizmi, drejtësia e rendi.

DEKRETIMI

Presidenti Meta dekretohet dhënie e gradës "Gjeneral Brigadë" për kolonel Albert Mullai. Kolonel Albert Mulla Mullai është "Komandant i Akademisë së Nënoficerëve Tomson", në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Dekreti i presidentit vjen në mbështetje të Kushtetutës dhe ligjit "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimtë të komandimit të Forcave të Armatosura".



Deputetët gjermanë në selinë e LSI, Rama: Qeveria dialogon me krimin

Një delegacion i parlamentit gjerman me deputetë nga Komisioni i Ligjeve dhe i Mbrojtjes së Konsumatorit i kryesuar kryetarit i komisionit Stephan Bradner takoi dje nënkryetarin e LSI-së, Luan Rama, ku ishin të pranishëm edhe deputetë të kësaj partie. Deputetët gjermanë u interesuan të dinin mbi situatën dhe zhvillimet politike në Shqipëri, mbi ecurinë e reformave dhe bashkëpunimin mes forcave politike parlamentare në Shqipëri. Zëvendëskryetari i LSI-së iu bëri të qartë deputetëve gjermanë se situata politike në Shqipëri dominohet nga konflikti ndërpartiak, nga mungesa e konsensusit, mungesa e transparencës dhe e tolerancës, nga raportet alarmante të krimit me qeverisjen, nga korrupsioni dhe arroganca e qeverisë. "Situata në Shqipëri është problematike dhe në kaos, reforma në drejtësi është e dështuar dhe në kolaps", tha z.Rama. Ai përmendi se, "është skandaloz fakti që Shqipëria është pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë. Në vijim Luan Rama duke iu përgjigjur interesimit të deputetëve gjermanë për mungesën e dialogut politik mes qeverisë dhe opozitës theksoi se qeveria ka zgjedhur të bashkëpunojë me krimin dhe jo me opozitën, mungon dialogu politik sepse qeveria bën dialog me kriminelët, ndaj pa u ndarë qeverisja me krimin dhe pa u vënë para ligjit të gjithë ata përfaqësues politikë me lidhje apo mbështetje kriminale, nuk rikthehet besimi qytetar tek institucionet dhe demokracia dhe qeveria asnjëherë nuk do të punojë për integrimin evropian të vendit.

24", kreu i grupit parlamentar të PD tha se misioni parësor i opozitës është "shkërmqoja" e qeverisjes së kryeministrit Rama. Sipas tij, shefi i qeverisë është ideatori dhe zbatuesi i planit për shkatërrimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Duke folur për procesin e zgjedhjeve lokale, të cilat do të zhvillohen vitin e ardhshëm, Spaho shtoi se PD është e vendosur të hyjë në garë, por me kushtin për të frenuar zhvillimin e zgjedhjeve kriminale. Ai mes tjerash pohoi se në 6 vitet e fundit në Shqipëri ka pasur thjesht votime e jo zgjedhje të lira e të ndershme. "Shqetësimi më i madh për PD-së është standardi i zgjedhjeve. As mos të kemi dyshim se PD do të hyjë në zgjedhje?! Në Shqipëri në 6 vitet e fundit është votuar, por nuk ka pasur zgjedhje normale. Ne do të punojmë fort që Shqipërisë t'i garantohen zgjedhjet e lira. Në Shqipëri, rezultatit e zgjedhjeve e përcaktonte krimi. Hoqëm Saimir

Tahirin të parin, i cili jepte 20 milionë euro në Tiranë. Misioni i opozitës është shkërmqoja e qeverisjes së Edi Ramës. PD ka ngritur shtabë elektorale në bashkitë e vendit. Edi Rama është ideatori dhe zbatuesi i manipulimit të zgjedhjeve. Pse ju mendoni se kjo qeveri jep garanci për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, por PD nuk do të lejojë që të kemi më zgjedhje farsë. Zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore të mbahen bashkë, është një opsion. Përpara se të arrijmë në zgjedhje vendore apo të përgjithshme së bashku, së pari duhet të garantojmë zgjedhje të lira. Mazhoranca ka uzurpuar kompetencat e të tjerëve. Kjo klikë duhet të çmontohet dhe më pas do të hyhet në zgjedhje normale", theksoi z.Spaho. Pas tij, në Presidencë mbërriti Luan Rama nga LSI, sipas të cilit problemi i zgjedhjeve nuk është data, por lidhja e qeverisë me krimin. Rama

nuk dha një qëndrim të qartë nëse LSI do të marrë pjesë në zgjedhje apo jo, por tha se me këto kushte zgjedhjet do të jenë vetëm formale. "Ndava me të shqetësimin që nuk është vetëm i LSI-së dhe i opozitës, që problemi i zgjedhjeve në Shqipëri nuk është data, por standardi dhe cilësia e tyre dhe ajo çfarë është më e rëndësishmja është pastrimi i zgjedhjeve nga interferenca, lobimi dhe trafikimi e blerja e grupeve kriminale. Një pushtet që buron nga veprimtaria dhe lobimi kriminal nuk mund të bëjë tjetër veçse të kthejë reston kriminale. Për sa kohë qeveria nuk ka vëmendje për të pastruar veten dhe zgjedhjet nga krimi, gjithçka tjetër është formale. Ky vend i mbytur nga kriminaliteti nuk ka nevojë për zgjedhje formale, por reale. Zgjedhje që garantojnë shprehjen e vullnetit të qytetarëve dhe jo të grupeve kriminale", theksoi z.Luan Rama.

OPOZITA AKUZAT

PD kërkon arrestimin, Saliانji: A e ka takuar Gjushi Cinen, po bandën e Durrësit?

PD: Shpërbleve kriminelët me pushtet. Dako: Gjyqi i ndan këto muhabete

"Vemje, do shkoni ushqim për pula"

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzon sërish kreun e Bashkisë së Durrësit se ka shpërblyer kriminelët me pasuri dhe pushtet për blerjen e votave për llogari të pushtetit të Edi Ramës. Deputeti demokrat, Ervin Saliانji akuzoi se Vangjush Dako, njësoj si Edi Rama, është peng i krimit. "I vetmi ndryshim mes tyre është se për Edi Ramën nuk kanë dalë akoma përgjimet me kriminelët, ndërsa për Vangjush Dakon, tani e kemi të provuar se i lutet kreut të bandës së Avdyllajve për takim falënderues pas zgjedhjeve, ushtarët me të cilët Dako komunikoi, refuzojnë ta shqetësojnë bosin", - deklaroi deputeti Saliانji. Demokratët akuzojnë Dakon se ka favorizuar bandat dhe përmend emra konkretë. "Vangjush Dako u betua se nuk u ka bërë bandave asnjë favor, por Partia Demokratike provoi se Avdyllajët kishin plazh privat në Durrës. Vangjush Dako, përveç përpëlqjeve qesharake, nuk tha cili është roli i tij në zgjerimin e biznesit të Avdyllajve. A e ka takuar Gjushi Cinen, një nga anëtarë të bandës, për t'i siguruar ndërtimin e Avdyllajve në det? Vangjush Dako duhet të thotë mbi çfarë kriteresh Peposhët e Durrësit, që terrorizuan zonën e Shkozetit gjatë zgjedhjeve, kanë marrë parkimin tek sheshi i Stacionit të Trenit. Vangjush Dako duhet të thotë mbi çfarë kriteresh emëroi administrator në Sukth, Bert Hoxhën, person me precedentë të rëndë kriminalë bashkë me vëllain e tij Gëzim Dankshi/Hoxha i cili u shpall në kërkim, pasi sulmoi me armë përfaqësuesit e PD-së në fushatën e Dakos 3 vjet më parë. Po persona të tjerë të lidhur me bandat e Durrësit apo të dënuar vetë për krime, që kanë mbledhur vota për Edi Ramën në zgjedhje si Rud Taullai me linjat e transportit urban ka përfutur privilegjet e pushtetit të Vangjush Dakos dhe Edi Ramës? Kep Arapi me ndërtime në mijëra metra katrorë tek Gjiri i Lalzit? Ron



Ervin Saliانji



Vangjush Dako

Tenderi i TVSH, Tabaku: Baxhanaku i Ramës, pjesë e skemës mafioze

Partia Demokratike akuzoi kryeministrin Edi Rama se nëpërmjet baxhanakut të tij ka ngritur atë që e quan skemë mafioze për të nxjerrë fitues kompaninë kroate të monopolit të kontrollit 'online' të faturimit të biznesit. Dy ditë më parë gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët, kryetari i opozitës, Lulzim Basha hodhi dyshime mbi pro-nësinë e kompanisë kro-ate, duke lënë të kuptohet se ata janë të afërm të ish-ambasadores Romana Vlahutin, kur tha se informacionet të çojnë se pas saj fshihet një ish-zyrtarë e lartë europiane në vendin tonë. Deputetja demokratike Jorida Tabaku deklaroi dje se pjesë e skemës mafioze është edhe baxhanaku i kryeministrit, kompania e të cilit sipas opozitës ka marrë pjesë në tender pa bërë asnjë ofertë, por vetëm për të legjitimuar procesin. "Në tenderin fasadë prej 15 milionë eurosh kanë marrë pjesë 3 garues. Dy prej tyre kanë qenë aty në garë për të legjitimuar skemën korruptive. Bashkëpunëtor në këtë skemë është edhe Armando Frangu, baxhanaku i kryeministrit Edi Rama. Përmes kompanisë së tij 'B 360', ai nuk ka dhënë asnjë ofertë në garën false për të legjitimuar fitoren e kompanisë kroate të tenderit korruptiv prej 15 milionë dollarësh", u shpreh zj.Tabaku.



Shqopa, drejtor i rëndësishëm në Durrës? Mbi çfarë kriteresh i kanë përfutur ata privilegjet e pushtetit të Vangjush Dakos dhe Edi Ramës?", deklaroi z.Saliانji. Në emër të PD-së, ai sërish kërkoi arrestimin e kryebashkiakut të Durrësit: "Në Shqipëri nuk ka për të pasur

proces normal politik derisa krimi elektoral që mban në pushtet qeverinë ilegjitime të Edi Ramës, të mos ndëshkohet". Por kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako reagoi dje pas akuzave të deputetit të PD-së, Ervin Saliانji, i cili u shpreh se kryebashkiaku i Durrësit i ka shpërblyer

ERVIN SALIANJI

"Krimi elektoral, blerja e votave nga bandat dhe shpërblyeri me pasuri të tyre nga Vangjush Dako duhet të ndëshkohet! Vangjush Dako duhet të arrestohet pa vonesë. Në Shqipëri nuk ka për të pasur proces normal politik derisa krimi elektoral që mban në pushtet qeverinë ilegjitime të Edi Ramës, të mos ndëshkohet", tha Saliانji.



Projekti i aeroportit të Kukësit

VANGJUSH DAKO

"Peshku i rezervatit paska nxjerrë sot (dje) këtë larvën e vet, Saliانjin me të cilin patjetër që do merrem në gjykatë. Megjithatë, gjyqi i ndan këto muhabete dhe zgjedhjet padyshim, ku këta do shkojnë ushqim për pula... Megjithëse edhe pulat zor se i hanë këto lloj vemjesh", - shprehet z.Dako.

Artur Metani, Avokat i ri i Shtetit

Largimi i Hickës, Rama: Alma u largua vetë! PD: Do e çosh në Gjykatën e Lartë

Alma Hicka nuk është më Avokate e Shtetit shqiptar. Mandati i saj në këtë detyrë ka mbaruar dhe Hicka mësohet se nuk ka dashur ta rinovojë. Në vend të saj, kryeministri Rama me propozim të Ministres së Drejtësisë, dje emëroi Artur Metanin. Fillimisht u raportua për shkarkimin e Hickës nga Rama, por ky i fundit në një postim në "Twitter", tha se zonja Hicka nuk është shkarkuar prej tij, por është larguar me dëshirën e saj për arsye personale. "Kazanët po ziejnë një broçkull për 'shkarkimin' e Alma Hickës. Në fakt, Alma u largua me dëshirën e saj, për arsye krejt personale e për gjithë keqardhjen time që e konsideroj një Avokate të shkëlqyer të Shtetit. Me neveri për kazanët i them Almës mos u mërzit e paç vetëm sukses. Hicka u emërua në krye të Avokaturës së Shtetit me 5 nëntor të 2013. Pas sqarimit të kryeministrit Rama se Avokatja e Shtetit nuk është shkarkuar nga detyra, por është larguar me vullnetin e saj për arsye personale, reagoi deputeti Enkelejdh Aliebaaj sipas të cilit si rrallëherë, Rama ka thënë për herë të parë të vërtetën. "Ai nuk e ka shkarkuar Alma Hickën. Edi Rama do ta çojë avokaten e korupsionit të tij, këshilltare në Gjykatën e Lartë, me qëllim për ta bërë anëtarë të Gjykatës së Lartë", - shprehet z.Aliebaaj.



er kriminelët me pasuri dhe pushtet. Përmes një postimi në "Facebook", Vangjush Dako shprehet se do padisë në gjykatë Saliانjin, pasi sipas tij, gjyqi i ndan këto muhabete. "Peshku i rezervatit paska nxjerrë sot (dje) këtë larvën e vet, Saliانjin me të cilin patjetër që do merrem

në gjykatë. Sepse këtij larvës ia ka thënë ca fjalë tamam edhe Grida, po ky është populli kot fare! Megjithatë, gjyqi i ndan këto muhabete dhe zgjedhjet padyshim, ku këta do shkojnë ushqim për pula... Megjithëse edhe pulat zor se i hanë këto lloj vemjesh", - shprehet z.Dako.

ZEVENDESIMET



Kuvendi organizoi dëgjues me 15 kandidatët për Këshillin e BSH

Komisioni i Ekonomisë dëgjo dje 15 kandidataturat që konkurrojnë për zëvendësimin e 3 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të cilëve u ka mbaruar mandati. Nga ky proces do të përzgjidhen tre anëtarët, që sipas ligjit propozohen nga Kuvendi. Ndërkohë edhe Kryeministria ka hapur aplikimet për të zëvendësuar tre anëtarët e tjerë që, sipas ligjit propozohen prej saj. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që u mbaron mandati dhe duhet të zëvendësohen janë Elisabeta Gjoni, Dhori Kule, Petraq Milo, Ela Golemi, Arben Malaj dhe Denada Prifti.



Kryeministri: Bashkimi doganor me Kosovën do bëhet, nuk na ndalojnë dot

'300 mijë udhëtarë në vit', Rama: Në janar nis aeroporti i Kukësit

"Valbona turistike do të ketë hotel me 5 yje"

Kryeministri Edi Rama mbledhi dje qeverinë në Kukës, ndërkohë që u shfaq shumë entuziazmi në Shishtavec, për ndërtimin dhe funksionimin e aeroportit të Kukësit, sipas të cilit do transformojë zonën në një nga modelet e turizmit malor. Rama deklaroi se ndërtimi i tij do të nisë në fillim të vitit të ardhshëm dhe sipas një studimi, ky aeroport parashikohet të ketë një lëvizje mesatare prej 300 mijë udhëtarësh në vit. "Unë besoj shumë që në këtë zonë ne do të shohim modelet e para të zhvillimit të turizmit malor edhe për një arsye tjetër, sepse këtu në Kukës, besoj në fillim të vitit të ardhshëm do të nisë ndërtimi i aeroportit të Kukësit. "Aeroporti ekzistues do të transformohet tërësisht në një aeroport të standardeve ndërkombëtare për fluturimet me çmime të ulëta dhe studimi që ne kemi bërë me ekspertë të huaj na ka inkurajuar shumë. Edhe mua më ka entuziazmuar shumë, sepse të gjitha analizat e bëra sipas metodave profesionale të parashikimit për suksesin e një biznesi tregojnë se aeroporti i Kukësit do të lëvizë në një mesatare prej 300 mijë udhëtarësh në vit", theksoi z.Rama.



Kryeministri Edi Rama

mbylljes së pikave të basteve dhe lojërave të fatit, ana tjetër është mbrojtja e domosdoshme e adoleshentëve nga alkooli. Gjërat kanë shkuar në një pikë që nuk mund të tolerohet më në bashkëpunim me shkollën dhe prindërit. Do të ndalohet frekuentimi i adoleshentëve në klubet e natës. Vetëm kur të jenë të shoqëruar me prindër apo mësues, ndryshe do të jetë e ndaluar rreptësisht. Masat do të jenë të rënda, që do të shkojë deri në mbylljen e lokaleve për një vit duke ua bërë të pamundur dhënien me qira të lokaleve", deklaroi z.Rama.

INVESTIMI

Pas përfundimit të mbledhjes së qeverisë në qarkun e Kukësit, kryeministri Rama tha se po punohet intensivisht për të vënë në punë pistën e skive në Shishtavec. Shefi i qeverisë deklaroi se do të ndërrhyhet në aksin rrugor Kukës-Has-Tropojë për t'i dhënë atë që i ka munguar kësaj zone. Gjithashtu, Rama shtoi faktin se vitin e ardhshëm do të ndërtohet hoteli i parë me 5 yje në zonën e Valbonës. "Po punojmë ngushtë me disa investitorë për të investuar në zonën e Shishtavecit. Vitin e ardhshëm do të kemi hotelin me 5 yje në zonën e Valbonës. Mbështesim familjet e kësaj zone, jo vetëm për argotizmin. Do të kemi një ndërhyrje në rrugën Kukës-Has-Tropojë. Do të kemi një paketë të re investimesh", theksoi z.Rama.

sipas të cilëve diçka e tillë do të ndodhte vetëm kur këto vende të hyjnë në BE, Rama tha se, "ata nuk na ndalojnë dot dhe s'kanë as pse të na ndalojnë. Së pari, nuk flasim për Shqipëri dhe Kosovë pa dogana, flasim për bashkim doganor dhe kjo nuk ka asnjë arsye të shikohet me vështrim të vëngër; është e drejta e dy shteteve tona të bëjmë një marrëveshje. Ne kemi qenë gati prej vitit të shkuar, Kosova nuk ishte gati, por ne po përgatimis mblehdjen tjetër që do të mbahet në fund të nëntorit në Kosovë dhe besoj se jemi gati të vendosim për Bashkimin Doganor. Kjo do të thotë se Durrësi do të bëhet dogana e përbashkët për të gjithë mallrat që hyjnë drejt Kosovës, ndërsa këtu do të kemi një shërbim dhe jo dy palë kontrolle, dy palë shër-

bime dhe dy palë dhimbje koke", deklaroi z.Rama. Kreu i ekzekutivit tha se nëse diçka të tillë e dëshiron edhe Serbia, kjo mund të ndodhë.

NISMA

Përveç ndalimit të alkoolit, adoleshentët do ta kenë të pamundur të shkojnë edhe në lokale e natës. Kryeministri Edi Rama bëri me dije nga Kukësi se ligji për ndalimin e alkoolit do të shkojë në parlament shumë shpejt, pasi sipas tij, situata ka shkuar në atë pikë sa nuk mund të tolerohet më. "Ligji do të shkojë në parlament. Masat janë shumë të rënda dhe duke sanksionuar rëndë të gjitha lokalet që shkelin këtë ligj dhe që do të pranojnë të hyjnë në dyert e tyre gjatë orëve të mësimi, paravarsisht nëse marrin apo nuk marrin alkool. Ndëshkimet do të jenë ekstreme. Pas

BASHKIMI DOGANOR
Nga Kukësi, ku zhvilloi mbledhjen e qeverisë, kryeministri Edi Rama tha se bashkimi doganor Kosovë-Shqipëri do të ndodhë dhe askush nuk e ndalon dot këtë. I pyetur për komentet e ndërkombëtarëve,

"Me patatet çfarë do bëjmë", Paloka ironizon Ramën në Shishtavec

Pas një takimi që zhvilloi kryeministri Edi Rama në Shishtavec të Kukësit, në kuadër të programit "100 fshatrat", nënkryetari i PD-së, Edi Paloka ironizoi për projektin për turizmin në këtë zonë për ndërtimin e një resorti. Sipas Palokës, resorti në fjalë do të konkurrojë Zvicerën dhe Austrinë. "Rama sapo 'ndërtoi' në Shishtavec resortin më të madh dhe më luksoz në Evropë për ski... Një burrë që Rama e kishte marrë me vete foli në anglisht për gati një orë. Duke filluar nga sot, 'resorti' i Shishtavecit për ski jo vetëm do linte në bisht Zvicerën, Austrinë e me radhë, por edhe kampionatet më të rëndësishme të skive do fillojnë të zhvillohen nga sot në Shishtavec. Kur mbaroi prezantimi në 3D i 'resortit', një prej fermerëve që kishte dëgjuar për një orë pa folur, e pyeti burrin që fliste anglisht: Po me patatet çfarë do bëjmë...?", shkruan Paloka.



INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA

The Contracting authority intends to award a service contract for **Support for the implementation of Population and Housing Census 2020**, Albania Location – Albania (AL) with financial assistance from the European Union. The contract notice is available at <http://www.instat.gov.al/en/about-us/census-of-population-and-housing-2020-in-albania/procurement-procedures/>

The deadline for submission of applications is **27 November 2018**.

INSTITUTI I STATISTIKAVE TË SHQIPËRISË

Autoriteti Kontraktor INSTAT, ka për qëllim dhënien e një kontrate shërbimi për "Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Cens 2020" Shqipëri, Vendlodhja - Shqipëri (AL) me ndihmë financiare nga Bashkimi Europian. Njoftimi i kontratës është publikuar në: Anglisht: <http://www.instat.gov.al/en/about-us/census-of-population-and-housing-2020-in-albania/procurement-procedures/>; Shqip: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/censi-i-popullsise%20n%C3%AB-dhe-banesave-2020-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/procedura-prokurimi/>

Data e fundit për paraqitjen e aplikimeve është **27 Nëntor 2018**.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje dhe aksesore të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,718,400 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pajisje dhe aksesore të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 03 Dhjetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Policia: Ja si funksiononte skema e kontrabandimit të refugjatëve

Goditet grupi kriminal, trafikonin sirianë nga Mali i Zi drejt Europës

Operacioni "GRE-HOT", përfundojnë në pranga pesë persona dhe një shpallet në kërkim

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Pesë persona kanë përfunduar në pranga dhe një tjetër është shpallur në kërkim, pasi akuzohen për veprat penale: "Trafikimi i qenieve njerëzore" dhe "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit". Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë Vendore të Shkodrës dje bënë me dije se gjatë operacionit të koduar "GRE-HOT" u arrestuan shtetasit: Ndue Ulaj, 33 vjeç, banues në fshatin Vrakë, Malësi e Madhe; Sajmir Karaj, 34 vjeç, banues në Tiranë; Florind Tole, 26 vjeç, banues në Tiranë; Griseld Dekovi, 24 vjeç, banues në lagjen Dobraq, Shkodër dhe Gjokë Murçaj, 33 vjeç, banues në lagjen Partizani, Shkodër. Ndërsa po punohet intensivisht për kapjen e shtetasit me inicialet P.P. Sipas bluve, arrestimi i këtyre personave u bë pasi gjatë hetimeve të zhvilluara nga ana e strukturave të Policisë, ata siguronin prirjen, transportimin dhe ambientet e akomodimit si hotele dhe shtëpi banimi për shtetasit e huaj të vendeve të treta, kryesisht sirianë dhe bënë mundur trafikimin e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt Malit të Zi me destinacion përfundimtar



Operacioni i policisë "GRE-HOT"

GRUPI KRIMINAL

Burime zyrtare nga policia vendore e Shkodrës dje bënë me dije se pas hetimeve të kryera ka rezultuar se ky grup i strukturuar kriminal në trafikimin e qenieve njerëzore ushtronte aktivitetin nga Greqia në qytetet Korçë-Elbasan-Tiranë-Lezhë-Shkodër-Malësi e Madhe dhe në pas kalimin në Malin e Zi.

vendet e BE-së. Pas hetimeve të kryera ka rezultuar se ky grup i strukturuar kriminal në trafikimin e qenieve njerëzore ushtronte aktivitetin nga Greqia në qytetet

OPERACIONI I KODUAR "GRE-HOT"

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Ndue Ulaj, 33 vjeç, banues në fshatin Vrakë, Malësi e Madhe.
2. Sajmir Karaj, 34 vjeç, banues në Tiranë.
3. Florind Tole, 26 vjeç, banues në Tiranë.
4. Griseld Dekovi, 24 vjeç, banues në lagjen Dobraq, Shkodër.
5. Gjokë Murçaj, 33 vjeç, banues në lagjen Partizani, Shkodër.

NË KËRKMIM

Shtetasit me inicialet P.P.

Korçë-Elbasan-Tiranë-Lezhë-Shkodër-Malësi e Madhe dhe në pas kalimin në Malin e Zi. Ndërkaq, burimet e mësipërme pohuan se janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale: 3 automjete, të cilët përdoreshin për transportimin e shtetasve të huaj; një sasi euro që

iu është gjetur personave të arrestuar si dhe dhjetëra telefona celularë dhe karta SIM. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprat penale "Trafikimi i personave të rritur" dhe "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve".

SHKURT

KPK konfirmon në detyrë prokurorin Sokol Stojani

TIRANË - Sokol Stojani, prokurori që drejtoi grupin e hetimit për çështjen Gërdeci, ku asokohe i pandehur u mor edhe ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, doli dje në seancë dëgjimore përpara institucioneve të vetingut. Në procesin që nisi dje Komisioni i Pavarur i Komunimit konfirmoi në detyrë prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme. Nga hetimi i thelluar administrativ i kryer nga KPK, prokurori i karrierës, rezultoi pa probleme në të tria shtyllat e kontrollit. Sipas KPK, Sokol Stojani kreu deklaram të saktë të pasurisë.

Pjesë e bandës kriminale në Itali, kapet 52-vjeçari

DURRËS - Një 52-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Durrësit, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkomëtar. Burime zyrtare nga policia pohuan se Robens (Arben) Berberi 52 vjeç, banues në këtë qytet u kap me qëllim ekstradim drejt Italisë. Gjykatë e Milanos në Itali e ka dënuar me 18 vite burg për veprat penale "Organizatat kriminale" dhe "Trafik narkotikësh". Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme.

E tërhoqi kali zvarrë, humb jetën 14-vjeçari

LIBRAZHD - Ai dje do mbushte 14 vjeç, por vdekja e mori shumë shpejt pranë vetes pas një aksidenti tragjik. Bëhet fjalë për Q. Muçakun nga fshati Xhyrë i Librazhdit, i cili ishte përfaqësuar në një aksident të pazakontë në oborrin e shtëpisë së tij. Djali ishte tërhequr zvarrë për disa metra nga kali i shtëpisë, i cili ishte trembur. Duke qenë se kishte pasur të lidhur litarin në dorën e tij 14-vjeçari nuk ka mundur ta zgjidhë dot. Pavarësisht se minoreni u dërgua në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza" në Tiranë, ai ndërroi jetë nga plagët e marra.

Vdes në llixhat kosovarja, burri pëson gjendje shoku

ELBASAN - I hidhur ka rezultuar fakti i një qytetareje nga Kosova, e cila ka ndërruar jetën në llixhat e Elbasanit. Mësohet se e moshuara është gjetur e pajetë nga bashkëshorti i saj, i cili ka pësuar gjendje shoku pas skenës së rëndë. Pasi kishte bërë një shtëjtje jash-të, burri ishte rikthyer në hotel. E ndërsa gruaja e tij nuk i përgjigje, ai u detyrua që të shkëlmonte derën. Deri më tani nuk dihet se çfarë e ka shkakuar vdekjen e 60-vjeçares me inicialet E.L., ndërsa po hetohet për zbardhjen e ngjarjes.

"Rrezikuar jetën për shkak të mungesës së sinjalistikës"

Humbën gjatë udhëtimit për në Theth, 2 turistët nga Anglia e Holanda: Si na shpëtuan banorët e zonës

SHKODËR - Pak ditë më parë, dy turistë humbën në Theth të Dukagjinit, ndërsa u shpëtuan nga banorët e zonës pas më shumë se 5 orësh pritje në mes të maleve në një lartësi 2000 m. Chris Simm, 33 vjeç nga Anglia dhe Sanne Carbaat 27 vjeçe nga Holanda është çifti, i cili pa vdekjen me sy. Ata ishin nisur nga Valbona drejt Thethit për ta bërë në këmbë. Pasi kishin udhëtuar për 10 orë ka mjaftuar një rrugë e gabuar dhe e kanë parë veten të humbur mes maleve. Shkak për këtë devijim të gabuar që u rrezikoi jetën u bë një shenjë orientimi e pavendosur mirë. Chris Simm deklaroi se pas humbjes në mes të maleve gjithçka për ta u bë e vështirë. Ai shpreh se shqetësues është mungesa e sinjalistikës përgjatë rrugës Valbonë-Theth, rrugëtim që bëhet në këmbë. Ndërkaq, Sanne Carbaat, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregoi me detaje gjithçka që përjetoi me part-

MESAZHI

Turistët Chris Simm dhe Sanne Carbaat i kanë dërguar një mesazh Loren Nikajt se kanë humbur në mal dhe më pas ajo ka vijuar komunikimet deri sa është arritur të shpëtohen. Loren kërkon nga shteti që në zona si Thethi ku numri i turistëve është i madh të ngrihen nga ministritë dhe emergjencat skuadra të gatshme shpëtimtarësh të përbëra nga banorët e zonës.

nerin e saj. Ajo sqaroi se telefonata me Loren Nikajn u shpëtoi jetën. Ajo tha se e kishin njohur vajzën rastësisht dy ditë më përpara në kamping e saj "Legjenda" në hyrje të Shkodrës dhe u kish-të dhënë numrin e saj të celularit, kontakti ky i cili u shpëtoi jetën.

Çfarë ndodhi?

Jemi nisur në ora 8 të mëngjesit nga Valbona për të shkuar në këmbë deri në Theth. Koha ishte e mirë. Gjatë ecjes tek Bar Simoni që është përgjatë këtij rrugëtimi ne jemi ngatërruar dhe jemi futur djathtas, në vend që të shkonim majtas sepse shenjat e

orientimit nuk ishin të mira. Kemi ecur deri në orën 18:00 dhe pasi erdhën djemtë për ta na shpëtuar kemi ecur edhe 2 orë e gjysmë të tjera. Ecja ka qenë ose duke ecur rrugë malore ose duke zbritur.

Ishte shi, erë, borë, ftohtë?

Në fillim ka rënë shi dhe më pas era ishte shumë e fortë dhe problemi jonë ishte që të gjenim drr për të ndezur zjarr.

Sa orë qëndruat të vetmuar në vendim ku humbët?

Mbërritëm aty rreth orës 18:00 dhe djemtë erdhën për të na shpëtuar rreth orës



Turistët Chris Simm dhe Sanne Carbaat që humbën rrugën në Theth

23:00. Problemi ynë ishte se nuk e dinim ku ishim saktësisht dhe se ku mundeshim të shkonim të nesërmen dhe se sa të lodhur mund të ishim për të mbërritur në një vend tjetër.

Çfarë ndjetë në ato momente?

Në fillim kishim pak frikë. Ne nuk kemi humbur ndonjëherë dhe u ndjemë të frikësuar dhe pak budallenj për arsye se ne ishim shumë të përgatitur dhe në një moment ndaluan dhe menduam se ku kemi bërë gabimin. Kuptuam se ishim ngatërruar tek një shenjë dhe në vend që të shkonim në një drejtim të duhur, gabuam.

Kush ju gjeti ju?

Cesku, Niko dhe Françesku, tre djem nga Thethi. Pastaj ne folëm me Loren dhe i treguam se

djemtë na gjetën. Niko ishte ai që erdhi i pari tek vendi ku ishim dhe na mori. Rrugën e kthimit drejt Thethit e kemi bërë për dy orë e gjysmë, pra ka qenë shumë më e shkurtër se sa koha që pritëm.

Është hera e parë në Shqipëri dhe do e bënit sërish atë rrugëtim?

Po është hera e parë në Shqipëri, dhe pavarësisht çfarë ndodhi do e kishim bërë sërish rrugëtimin nga Valbona në Theth, por me një guidë ose me një hartë dhe të jemi pak më të përgatitur.

Kishit frikë se mund ta humbnit jetën?

Ne nuk kishim frikë për jetën sepse ne nuk e dinim ende se aty ka ujgër dhe arinj apo të tjera kafshë të egra. Menduam se ishim më afër një zone të banuar. **se.ni.**

U arrestuan në kuadër të operacionit të koduar "Ballkan" në vitin 2016

Trafiku i heroinës nga Turqia, dënohet me 10 vite burg biznesmeni Jurgen Molla

Ja dënimet e dhëna nga Krimet e Rënda për 8 anëtarët e tjerë të bandës, përfituan gjykim të shkurtuar

TIRANË

Gjykata e Krimeve të Rënda dje ka dhënë vendimin për anëtarët e bandës së biznesmenit Jurgen Molla, të cilët u vunë në pranga dy vite më parë. Në vendimin e saj, gjykata vlerësoi akuzat e dosjes së prokurorisë dhe vendosi dënimin me 15 vite burgim për Jurgen Mollën, që njihet se anëtar i kryesor i grupit. Ndërkohë që Molla nuk do të kryejë 15 vite, pasi pas uljes me 15 vite burgim për Jurgen Mollën, që njihet se anëtar i kryesor i grupit. Ndërkohë që Molla nuk do të kryejë 15 vite, pasi pas uljes me 15 vite burgim për Jurgen Mollën, që njihet se anëtar i kryesor i grupit. Ndërkohë që Molla nuk do të kryejë 15 vite, pasi pas uljes me 15 vite burgim për Jurgen Mollën, që njihet se anëtar i kryesor i grupit.

ARRESTIMI

Në korrik të vitit 2016, policia shqiptare deklaroi se në kuadër të operacionit "Ballkan" ishin arrestuar 30 persona dhe 23 të tjerë ishin shpallur në kërkim në Shqipëri, Greqi, Maqedoni dhe Bullgari. Procesi për një pjesë të të pandehurve po kryhet në vendet ku janë arrestuar.



Anesti Koromani



Jurgen Molla

DËNIMET E DHËNA PËR ANËTARËT E BANDËS

1. Jurgen Molla 15 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 10 vite.
2. Shyqyri Kotorri 14 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 9 vite e katër muaj.
3. Anesti Koromani 14 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 9 vite e katër muaj.
4. Arif Çiço 14 vite ujët 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 9 vjet e katër muaj
5. Enver Kurtulu? 13 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 8 vite e 8 muaj
6. Abubekir Tunçdemir 14 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 9 vjet e katër muaj.
7. Blerim Ukimeraj 12 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 8 vite
8. Elmi Thaqi 12 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 8 vite.
9. Orges Myftaraj 13 vite, ulet 1/3 e dënimit dhe do të vuajë 8 vite e tetë muaj.

"Furnizonin" kryeqytetin me kokainë dhe kanabis, arrestohen 2 shpërndarësit

TIRANË - Policia e Shtetit ka goditur dy raste të shpërndarjes së lëndëve narkotike në kryeqytet. Në vijim të punës për evidencimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundraligjshme të shpërndarjes së lëndëve narkotike, Seksioni kundër Narkotikëve arrestoi në flagrancë shtetasin Armando Dervishi, 21 vjeç, banues në Çorovodë. Mësohet se të riut, gjatë kontrollit të ushtruar në rrugën "Frederik Shiroka", iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 101 doza me lëndë të dyshuar narkotike e llojit "Kokainë". Gjithashtu, në pranga ra dhe Fatjon Shkalla, 24 vjeç, banues në Farkë. Sipas bluve,



gjatë kontrollit të ushtruar në Farkë në banesën e këtij shtetasi, në një kavanoz iu gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale 69 gr kanabis sativa. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprën penale "Prodhim dhe shitje lëndësh narkotike".

Permbuesi gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
 a) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekore me nr pasurie 144/25 ne Zonen Kadastrale 3217 me nr prone volumi 2, Fq 195, me sip totale 1937 m2 e ndodhur ne fshatin Rrashkullaj , Gruemirev, Malsi e Madhe. Cmimi per hapjen e ankandit eshte ne vleren 292,874 leke .
 b) Truali + Nourrese e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 15327 ne Zonen kadastrale 3217, me nr prone Volumi 2, Fqja 185 me sip totale 1902 m2, nga kjo Truali 200 m2 , Ndertese 50 m2 e ndodhur ne lagjen Rrashkullaj Gruemire, Malsi e Madhe . Cmimi per hapjen e ankandit eshte ne vleren 199,180 leke
 Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 05.11.2018 ora 16, 16 ne Zyren e permbuesit gjyqësore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Ferizade Gjykatës së mëtej Gjyqësore Shkodër. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkodër me nr llogarie 41064051.



Droga me destinacion Greqinë

Sekuestrohen 3.5 kg kokainë, prangoset 46-vjeçari nga Patosi

GJIROKASTËR - Një sasi prej 3.5 kg kokainë është sekuestruar nga Policia Kufitare e Kakavijës. Droga është zbuluar në një makinë "Mercedes Benz" me ngjyrë të zezë, që drejtohej nga një 46-vjeçar nga Patosi, i cili ka përfunduar në pranga. Burime zyrtare nga policia dje bënë me dije se gjatë kontrolleve të vazhdueshme për goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikeve të paligjshme u përzgjodh për kontroll të detajuar në vijën e dytë, automjeti i markës "Mercedes Benz", me targa AA216TF, me drejtues shtetasin Selim Lazaj, vjeç 46, banues në Patos, Fier. Sipas bluve, gjatë kontrollit të detajuar në bashkëpunim me shërbimet doganore, duke përdorur edhe skanerin, u konstatua se në baterinë e automjetit gjendeshin të fshihura dy pako të mbështjella me natriban, të dyshuara me lëndë narkotike të llojit kokainë. Nga peshimi i pakove rezultoi se brenda tyre kishte një sasi prej 3 kg e 545 gr kokainë, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Në përfundim të veprimeve të kryera nga specialistët për Hetimin Narkotikëve u bë arrestimi në flagrancë i 46-vjeçarit për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve". Materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Njoftim për shitje me ankand
 Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. ne baze te nenit 567.568 te K.Pr. Civile do te zhvilloje ankandin e pare per pasurine e debitorit S Shera, dhe O. Shera. Pasuria qe shtet ne ankand perbehet nga :
 "Dygan" me numër pasurie 6/279, Vol. 37, Fq. 64, ne Z.K Nr. 8350, me sferfaqe 35 m2, e ne Zrpp Tiranë. Ankandi fillon me çmimin fillestar ne masën 36.400 Euro
 "Dygan" me numër pasurie 6/279, me Z. Nr. 8350, me sferfaqe 4.8 m2, ne Zrpp Tiranë Ankandi i pasurisë "Dygan" fillon me çmimin fillestar ne masën 3.840 Euro
 Ankandi do te zhvillohet ne date 12.11.2018 prej orës 15:00 ne selin e shoqerise Bulv "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5. Ofertesit mund te paraqiten ose te kontaktojnë tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir.dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.



Kushtet në konviktet e qytet studentit

Flet studentja: Hapësirë e pamjaftueshme. Jemi ndeshur me arrogancën e administratorëve

Voltiza Duro

Pamundësia për të përballuar qiratë e larta të shpesh, i detyron shumë studentë nga rrethet të strehohen në konviktet e Qytetit Studentit. Por, kushtet vazhdojnë të mbeten të mjerueshme për rreth 5 mijë të rinj që kanë zgjedhur si strehën e tyre dhomat plot lagështirë e pa hapësirë të mjaftueshme për të jetuar. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Arbiona Çibukaj, studente në vitin e dytë e njëkohësisht aktiviste e lëvizjes "Për Universitetin" tregon se kushtet higjienike lënë për të dëshiruar, pasi në tualete nuk ka as letra higjienike dhe as larës duarsh. Ajo shton se detyrohen të paguajnë 450 mijë lekë të vjetra për një vit për mjerimin me të cilin bashkëjetojnë çdo ditë. Çibukaj bën me dije se kanë organizuar disa aksione simbolike për t'i dhënë një zgjidhje situatës, por deri më tani ankesat e tyre kanë rënë në vesh të shurdhët e madje u ndeshën edhe me arrogancën e administruesve të konvikteve.

Prej sa kohësh jetoni në konviktin e Qytetit Studentit?

Unë jam në vitin e dytë bachelor dhe prej dy vitesh jetoj në Qytet Studenti. Arsyet pse zgjodha të jetoja aty janë pak a shumë të njëjtat që shtynë çdo student tjetër t'i drejtohet Qytetit Studentit, pra kushtet ekonomike. Shtëpitë me qira janë të papërballueshme. Duke qenë se Qyteti Studenti është afër me një pjesë të mirë të fakulteteve, kjo është një tjetër shtysë që shumica zgjedhin atë vend, sepse do të duhet të luftosh edhe për të zgjidhur problemin famëkeq të abonesë në të kundërt.

Sa është pagesa për një vit?

Pagesa vjetore është 45000 lekë, por kushtet e jetesës nuk e justifikojnë shumë. Një dhomë 20 metra katrorë, e cila ndahet me person tjetër paguhet 13500 lekë. Në dukje të parë, tarifa e konviktit mund të na duket më e ulët se qiraja e shtëpisë, por po të bësh një përlogaritje të vogël bazuar në metër katror rezulton se Qyteti Studenti është më i shtrenjtë se shtëpitë me qira.

Si paraqiten kushtet, a janë të përstatshme për të jetuar?

Për kushtet e konvikteve është folur shpesh dhe si përfundim janë ende në gjendje

"Kushtet e mjerueshme në konvikte, nuk ka as ujë e as letër higjienike"

Arbjona Çibukaj: Flemë në dyshekë me susta të dala

KUSHTET

Për kushtet e konvikteve është folur shpesh dhe si përfundim janë ende në gjendje të mjerueshme. Dhoma të vogla ku jetojnë tre persona, hapësira nuk është e mjaftueshme as për të lëvizur lirshëm jo më për të tjerat. Përveç krevatit dhe dyshekëve me susta të dala, nuk gjejmë asgjë tjetër në dhomë.



Arbjona Çibukaj

ÇMIMET E USHQIMIT

Ushqimi mbetet një tjetër problem që kanë studentët që vinë nga rrethet. Disa përpiqen të gatuajnë vetë, por shpeshherë gatimi në dhomë është i pamundur, sidomos në rastet kur në një dhomë jetojnë tre persona. Përveç erës së ushqimit që do më shumë se një orë të largohet nga dhoma, duhet të biesh në kompromis edhe me vajzat e tjera se kush do të gatuajë e para.

të mjerueshme. Dhoma të vogla ku jetojnë tre persona, hapësira nuk është e mjaftueshme as për të lëvizur lirshëm jo më për të tjerat. Përveç krevatit dhe dyshekëve me susta të dala, nuk gjejmë asgjë tjetër në dhomë. Çdo mjet tjetër të nevojshëm e sigurojmë nga buxheti ynë.

Sa veta jetoni në një dhomë dhe a ka hapësirë të

mjaftueshme?

Për fatin tim të mirë e ndaj dhomën vetëm me një vajzë tjetër, por në 80% të dhomave jetojnë nga tre persona. Sic e përmenda edhe me lart, hapësira lë shumë për të dëshiruar. Dikush do të studiojë, dikush tjetër të gatuajë, dikush do të flejë, imagjinojeni pak se si mund ta shtynë çdo ditë kështu. Për rastin e

studimit na janë përgjigjur duke na thënë se ka dhoma studimi. Këto përveç kushteve minimale që kanë, nuk kanë as kapacitet të mjaftueshëm për të gjithë studentët. Unë asnjëherë nuk kam gjetur vend tek salla e studimit, është gjithnjë e tejmbushur.

A ka çdo dhomë dushin e vet apo janë të përbashkëta? A ka ujë në çdo orë të ditës?

Nuk është as mit, as gojëdhënë, por dhomat nuk kanë tualete personale. Kemi dushë dhe tualet të përbashkëta, të cilat janë të gjendje të mjerë. Për sa u përket dushëve, ato janë me orar; nuk ka ujë të ngrohtë 24 orë, kjo shkakton dhe atë radhën e gjatë që të gjithë e kanë dëgjuar.

Si paraqiten çmimet në mensa, a janë të përballueshme për një student?

Ushqimi mbetet një tjetër problem që kanë studentët që vinë nga rrethet. Disa përpiqen të gatuajnë vetë, por shpeshherë gatimi në dhomë është i pamundur, sidomos në

rastet kur në një dhomë jetojnë tre persona. Përveç erës së ushqimit që do më shumë se një orë të largohet nga dhoma, duhet të biesh në kompromis edhe me vajzat e tjera se kush do të gatuajë e para. Kështu që disa studentë u drejtohen mensave, ku dihet se ato që kanë disa çmime me të lira kanë pasojat të tjera, duke qenë se cilësia e ushqimit lë për të dëshiruar. Pastaj kur fillon dhe vë në diskutim cilësinë, rritet çmimi dhe koston mbeten sërish të papërballueshme për një student, i cili e ka buxhetin javor afërsisht 3000 lekë.

Po kushtet higjienike si janë?

Kushtet higjienike lënë për të dëshiruar; në tualete nuk ka as letra higjienike dhe as larës duarsh. Për të mos të folur për kovat dhe fuçitë me ujë, të cilat përdoren për t'u hedhur ujë WC-ve në mungesë të shkarkuesve dhe mungesës së ujit 24 orë.

A keni bërë ndonjë

kërkesë për rehabilitimin e kushteve dhe cila është përgjigja që keni marrë nga instancat përkatëse?

Vitin e kaluar lëvizja "Për Universitetin" së bashku me studentët që jetojnë në Qytet Studenti ndërmorëm një aksion simbolik për të risjellë në vëmendje kushtet e mjerueshme të konvikteve. Nga ana e drejtorisë nuk pati asnjë reagim pozitiv, përveç arrogancës së administruesve të tyre.

A do të vazhdoni të qëndroni në konvikte apo do të shikoni mundësinë e një shtëpie me qira?

Jo, nuk do të vazhdoj të jetoj më në konvikte. Vitin tjetër do të shoh për mundësinë e një shtëpie me qira që ta ndaj me dikë tjetër, pasi nuk e përballoj dot e vetme as dhe një garsoniere. Por kjo nuk është zgjidhje. Edhe sa kohe do të vazhdojnë këto godina të qëndrojnë në këto kushte? Edhe sa breza do të përcillen kështu?



Gramoz Ruçi: Shërben si vlerë e shtuar për vendin. Mundësi praktike për studentët

23 universitete nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë

Rektori i 'Luarasit': Bashkëpunimi, përfitim për universitetet

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, Ku vendi i Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me 23 universitete publike e private në vend si dhe me Akademinë e Shkencave. Kjo marrëveshje synon që institucionet e arsimit të lartë në vend, të jenë aktorë të fuqishëm në procesin legjislativ dhe kontrollin parlamentar. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, theksoi se përfshirja e universiteteve në ligjvërje mund të shndërrohet në një vlerë të shtuar për vendin dhe do të shërbejë si një praktikë e mirë edhe për studentët. "Kuvendi i Shqipërisë do të mbështesë universitetet dhe qendrat kërkimore që të bëhen aktorë më të fuqishëm dhe më të ndjeshëm në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të vendit, të shndërrohen në kantieri të ekonomisë së djesh, të kontribuojnë që rritja ekonomike të përkthehet" në vende pune e mirëqenie për qytetarët, të ngushtojë pabarazinë dhe të konsolidojë drejtësinë sociale", -tha Ruçi në fjalën e tij.

KRYETARI I KUVENDIT

"Kuvendi i Shqipërisë do të mbështesë universitetet dhe qendrat kërkimore që të bëhen aktorë më të fuqishëm dhe më të ndjeshëm në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të vendit, të shndërrohen në kantieri të ekonomisë së djesh, të kontribuojnë që rritja ekonomike të përkthehet" në vende pune e mirëqenie për qytetarët, të ngushtojë pabarazinë dhe të konsolidojë drejtësinë sociale", -tha Ruçi në fjalën e tij.



Kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi me rektorët e universiteteve

"BASHKËPUNIM I NDËRSJELLË"

"Jemi shumë të lumtur që jemi të gjithë këtu për të nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi të shumanshme me përfitim të ndërsjellë. Profesorët tanë të mirë të Drejtësisë janë të gatshëm që të marrin pjesë në komisione, kur ka debate. Sa më mirë të diskutohet një ligj në fazën paraprake, aq më mirë bëhet ligji, aq më mirë zbatohet dhe aq më shumë përfiton shoqëria", -u shpreh Ruka.

fundit, kemi pasur mjaft raste kur Kuvendi dhe komisionet parlamentare kanë ndryshuar përmbytjen e akteve ligjore ose kanë kushtëzuar miratimin e tyre me marrjen e rekomandimeve prej ekspertëve të botës akademike dhe universiteteve", -shtoi kreu i Kuvendit.

BASHKËPUNIMI

Rektori i universitetit "Luarasi", prof. dr Ethem Ruka, në fjalën e tij u shpreh se ky bashkëpunim i ndërsjellë do të sjellë përfitime për universitetet,

por edhe për vetë Kuvendin e Shqipërisë. Ai shtoi se pedagogët e "Luarasi"-t do të jenë të gatshëm për të marrë pjesë në debate. "Bashkëpunimi midis Kuvendit dhe universiteteve të Shqipërisë kalon në një fazë tjetër rritjeje. Jemi shumë të lumtur që jemi të gjithë këtu për të nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi të shumanshme me përfitim të ndërsjellë edhe për Kuvendin e Shqipërisë e veçanërisht për universitetet tona. Profesorët tanë të mirë të Drejtësisë janë të gatshëm

që të marrin pjesë në komisione, kur ka debate. Sa më mirë të diskutohet një ligj në fazën paraprake, aq më mirë bëhet ligji, aq më mirë zbatohet dhe aq më shumë përfiton shoqëria", -u shpreh rektori i universitetit Luarasi.

DISKUTIMI ME REKTORËT

Gjatë bashkëbisedimit u diskutua mbi disa çështje themelore, ku duhet të përqendrohet veprimtaria akademike e kërkimore-shkencore në Shqipëri. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe

fuqizimit të bashkëpunimit midis universiteteve e qendrave kërkimore. Marrëveshjet parashikojnë shfrytëzimin e ekspertizës dhe kompetencës shkencore të universiteteve dhe qendrave kërkimore të vendit në procesin legjislativ dhe kontrollin parlamentar, si një vlerë e shtuar dhe e mirë publike për vendin. Marrëveshjet nxisin rritjen e fuqisë kontraktuale të universiteteve dhe qendrave kërkimore në tregun e kërkimit shkencor në Shqipëri. Marrëveshjet parashikojnë, gjithashtu,

që studentët do të kenë mundësi të bëjnë më shumë praktika pune në Kuvendin e Shqipërisë dhe universitetet të kenë më shumë akses në burimet dhe veprimtaritë e Kuvendit. Rektorët e falënderuan Kryetarin e Kuvendit për këtë mundësi të re që u krijoi universiteteve e qendrave kërkimore, Kuvendi i Shqipërisë. Ata e vlerësuan si një ngjarje të rëndësishme faktin që për herë të parë universitetet shqiptare thirren në Kuvend me një ofertë konkrete bashkëpunimi.

114 të rinj shqiptarë, studime në AUBG

Ish-presidenti bullgar në Tiranë për karrierat e së ardhmes

PRESIDENTI BULLGAR

Në fjalimin e tij në Tiranë, Presidenti do të fokusohet në karrierën e së ardhmes. Studentë potencialë dhe prindërit e tyre, autoritete lokale, drejtorë të shkollave të mesme dhe mësues janë fuar të marrin pjesë.

që bën përparime të mëdha në teknologji, përfshirë përparimin e Inteligjencës Artificiale, por që, gjithashtu, përballet me çështjet globale që kanë të bëjnë me mjedisin dhe transformimin e shoqërive në mbarë botën, universitetet duhet gjithnjë

e më shumë t'i përgjigjen nevojës për liderë të rinj - me mendime të reja dhe një sërë aftësish që janë globalisht të përshtatshme. Universiteti Amerikan në Bullgari është një vend ku ky trend është kthyer në prioritet", -thotë Rosen Plevneliev. Aktualisht

114 studentë nga Shqipëria studiojnë tek AUBG. Rreth 304 të rinj nga Shqipëria janë pjesë e komunitetit global të të diplomuarve të universitetit. Njëri prej tyre, Olti Mitre, klasa e vitit 2011, i cili është diplomuar në AUBG me dy diploma, Ekonomi dhe Administrim Biznesi, do të flasë në këtë eveniment. Aktualisht ai është i punësuar në Bankën e Shqipërisë. Për më shumë se dy dekada, AUBG ka qenë lider në arsimin e arteve liberale dhe një institucion i arsimit të lartë i akredituar plotësisht, që ofron si një diplomë të BE-së, ashtu edhe një diplomë amerikane. Në fillim



Ish-Presidenti bullgar, Rosen Plevneliev

të vitit të ri akademik në shtator, u raportua një rritje rreth 30% për regjistrimet. Nxënësit e AUBG-së përfaqësojnë më shumë se 40 kombësi. Ata janë tërhequr në

radhë të parë nga stili i arsimit amerikan që ofron një numër të madh të diplomave për të lehtësuar suksesin në karrierën e tyre globale.

Të shtunën, më 3 nëntor 2018, në Tiranë do organizohet një event ku folës kryesor do të jetë ish-Presidenti bullgar, Rosen Plevneliev. Prej vjeshtës të vitit 2017, zoti Plevneliev ka qenë përfaqësues special i Universitetit Amerikan të Bullgarisë (AUBG), me bazë në Blagoevgrad. Në fjalimin e tij në Tiranë, Presidenti do të fokusohet në karrierën e së ardhmes. Studentë potencialë dhe prindërit e tyre, autoritete lokale, drejtorë të shkollave të mesme dhe mësues janë fuar të marrin pjesë. Seksioni pyetje dhe përgjigje është, gjithashtu, pjesë e programit dhe AUBG me shumë dëshirë do u përgjigjet pyetjeve nga audienca. "Në një botë

Zbulohet e vërteta e lajmit që po qarkullon në media

Një hap drejt fejesës! Anxhela Peristeri shumë shpejt kurorëzon dashurinë

"Nuk ka asgjë të keqe të dashurosh"

Egla Xhemali

Anxhela Peristeri një nga zërat më të bukur të muzikës shqiptare, por kur vjen puna për jetën private ajo ka preferuar gjithmonë ta mbajë larg vëmendjes mediatike. Ai njihet si një nga zërat më kritikë për çdo personazh publik të show bizz-it shqiptar. E kemi fjalën këtu për blogerin e njohur Olti Currin, i cili ka hedhur dyshimet me deklaratën e tij në emisionin "Rudina", në Tv Klan, ku ka thënë se këngëtarja në festën e ditëlindjes së saj kishte ndaluar fotot. "Unë kam qenë në ditëlindjen e Anxhelës para pak kohësh dhe urdhri ishte: Mos bëni asnjë foto. Ajo unaza më pëlqen shumë dhe i rri shumë mirë Anxhelës", tha Olti. Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë të ditur se lajmi për fejesën e Anxhelës është i vërtetë dhe po, ajo është në prag të kurorëzimit të dashurisë, shumë shpejt këngëtarja e njohur do fejojë. Ende nuk është bëri i ditur djali, i cili i ka rrëmbyer zemrën bukuroshes megjithëse për një gjë jemi të sigurt që ajo është në periudhën më të bukur për të nisur tanimë diçka serioze. Gjithë këto lajme që po qarkullojnë për të nuk kishin si të mos merrnin reagime. Ka qenë Peristeri vetë që ka pohuar se gjithçka është e kotë dhe se me të nuk ka ndodhur asgjë e re. Anxhela ishte e ftuar në "Rudina", ku foli lidhur me unazën që mban në gisht. Këngëtarja tha se mban prej vitesh unazë dhe sqaroi se ende nuk ka marrë një propozim. Ajo shprehej se ende nuk ka diçka konkrete për të ndarë me publikun. "Ai lajmi ka dalë kot, sepse unë kam katër vjet me unazë në gisht dhe tek të gjitha emisionet e tua kam qenë me unazë. Nuk ma kanë dhuruar akoma unazën e fejesës fatkeqësisht. Nuk kam marrë propozim deri tani. Ka dalë një lajm kot, sepse po të hysh në fotot e mia ndër vite janë me unazë. Fakti që unë nuk doja që të bëheshin fotografi në festën e ditëlindjes time është se njerëzit sa herë dalin hutohen në celular dhe nuk e kanë mendjen fare tek argëti-



mi. Dhe unë doja që askush të mos merrej me celularin, atë natë doja që të bënim qejf. Olti

që i ka thënë ato fjalë diçka di, megjithatë në momentin e parë që do të kam diçka

konkrete, unë do ta them, sepse nuk ka asgjë të keqe të dashurosh", tha Peristeri. Dhe pse ajo




ka mohuar gjithçka me gjasë shumë shpejt do dali ndokund për të thënë të vërtetën. Deri

atëherë ne urojmë që Anxhela të shijojë ditët në krah të të dashurit të saj.



Armina një lepurushe e ëmbël që feston "Halloween"

Thuajse të gjithë VIP-at i kapi mania për të festuar Halloweenin. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe dhe me të. Armina Mevlani padyshim nuk mund të qëndronte pa veshur një kostum Halloweeni. Blogeria simpatike shqiptare është veshur e gjitha në të zeza me një dekolte që i nxjerr në pah të gjithë gjoksin. Armina ka zgjedhur të jetë një lepurushe seksi këtë festë, duke u dukur mjaft sensuale dhe në formë.



Klea Huta më e nxehtë se kurrë, moderatorja poston imazhe provokuese

Ajo është një nga moderatorët më të ëmbla dhe një fakt të tillë e tregon në shumicën e postimeve apo daljeve të saj. Këtë herë bukurshja Klea Huta ka publikuar një foto artistike në rrjetin social "Instagram", ku shfaqet seksi dhe joshëse në një sfond të bardhë. Krahas fotos Klea ka shkruar: "Paqja është e bukura e jetës,"-përfundon Klea në rrjete sociale.



Enca nxjerr skenat e nxehta të videoklipit të saj

Projekti i saj "Dua" që u publikua në mars të këtij viti dhe suksesi i kësaj kënge vijon ende. Përveç këngës së bukur, interesant ishte edhe klipit në të cilin këngëtarja shfaqej me modelin e njohur Pierluigi Fracassi, për të cilin është zbuluar se është gay. E mesa duket, Enca me Pierluigin nuk është puthur vetëm në videoklip, por edhe në prapaskena. Këtë e ka zbuluar vetë këngëtarja që e ka ndarë këtë moment intim në profilin e saj në "Instagram". "Sapo kuptova që nuk kam nxjerrë prapaskenat e klipit 'Dua' ... dhe ja ku është njëra",-shkruan këngëtarja krahas videos së postuar në "Instagram".



Plas sherri mes reperave! Ja çfarë ka ndodhur mes këngëtarëve

Nga anëtarë të një grupi dhe shokë të mirë, duket se Ledri Vula dhe Agon Amiga nuk i kanë aspak marrëdhëniet mirë së bashku. Kjo shihet në këngën më të re që ka nxjerrë reperi i njohur Agon Amiga, në një pjesë të tekstit të së cilit, shumë fansa mendojnë se ai ka bërë një diss kundrejt Ledrit. "Unë s'po shoh Vulë, unë po shoh ku've, unë po shoh gay", shprehet Agoni dhe shumë njerëz kanë menduar se ky është një dedikim kundrejt Ledri Vulës.



BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Dhëshkronja njerëzore e Samiut dhe gjeopolitika shqiptare

Gjeografia njerëzore e Albert Hitoaliajt...

NGA PANO HALLKO

Në vendin tonë, sido mos njëzetë vitet e fundit, është derdhur shumë bojë në letër, sa për problemet e strategjirave, aq edhe për çështjet e gjeopolitikës. Strategjira (brenda dhe jashtë thonjëzave), janë printuar shumë, aq shumë dhe aq të shpëllara, sa që asnjëra prej tyre nuk i ka hyrë e nuk do t'i hyjë në punë këtij vendi. E me të janë mbrojtur grada shkencore, e me të janë pushtuar kolltukët të rëndë të pushtetit, e me të janë vjedhur në mënyrën më të pa skrupullit gjithçka pati të mirë e prodhoi ky vend në tridhjetë vitet e fundit. Po kështu, edhe për gjeopolitikën.


Por të gjeopolitika gjërat ishin më me këmbë në tokë. E kjo falë institucionit që patëm dikur, Akademisë Ushtarake, e cila kishte tagrin e Akademisë së Sigurisë. Në të cilën punonin dhe krijonin njerëz të përkushtuar, në të cilin zinin fill, edhe fjalitë e Strategjisë sonë Kombëtare. Pavarësisht shtrembërimeve që pësonin ato fjalë, në zyrat e "institucioneve" të tjera shtetërore.

U fshi me një të rënë të lapsit bordi i profesorëve, pa pyetur asnjë ushtarak para veçës vitesh, a thua se marrin vesh nga këto punë ata, që u ulën në kolltukët e godinës asokohe. Kuptohet, për llogaritë të ca dyqaneve private të Tiranës, që printojnë edhe... "mastera" e "doktoratura" për... Sigurinë!

Ashtu siç, me të njëjtën alergji, ai staf "menaxhues", mbyllti organet e shtypit ushtarak, të cilat shtypeshin me shaptilograf, edhe në ditët më të zeza të Luftës së II Botërore. Ashtu siç mbyllën masterat e të dy niveleve për Sigurinë...

Stafi i ri që erdhi shtatorin e kaluar në Ministrinë e Mbrojtjes pati meritën që të zhbllokonte mbrojtjen e doktoraturave të bllokua. Kjo, edhe falë punës së intelektualit ushtarak në krye të Komandës së Doktrinave, Prof. dr. Gjeneralbrigade, Bajram Bega. Pasi ato ishin bllokuar në çastin kur ishin përfunduar temat, madje ishin depozituar të gjitha materialet në sekretarinë e Akademisë, ishin paguar edhe lekët, në bankën përkatëse në llogarinë e Akademisë së Mbrojtjes.

Sivjet, më në fund u realizua ajo "e pamundura", u mbrojtën disertacionet, që ishin përgatitur prej vitesh. Doemos, që ka ndonjë "ujk", që kërkim mjequllën. Ashtu siç ka edhe ndonjë "dhelqep", që preferon vapën... Por le të mos humbasim "nordin", sepse përjashtimet mbeten përjash-



time....

Temat që u mbrojtën para komisioneve pas kaq shumë kohësh, doemos që kishin prurjet e tyre, interesante dhe me vlera. Në të gjithë zhanrin e tyre.

Por vetëm për njërin prej tyre, u tha: -Ky punim duhet të jetë...

...LIBËR NË TAVOLINËN E SHTETIT
Dhe këtë e tha me zë të lartë kryetari i Komisionit shtetëror, e jo shkruesi i këtyre radhëve...
Bëhet fjalë për emrin që citohet në titullin e shkrimit, për Disertacionin e Albert Hitoaliajt, me temën "Antropogjeografia shqiptare dhe gjeopolitika".

Në fakt, është hera e parë e punimi i parë i plotë, i një natyre të tillë në serinë e studimeve. Thënë ndryshe, ky studim është guri i parë në këtë disiplinë, por edhe një gur i rëndë në themel të shkencës së gjeopolitikës. Sepse bota ku duam të shkojmë, ka më se një shekull, të paktën institucionalisht, që në themel të gjeopolitikës, ka antropogjeografinë, apo gjeografinë njerëzore, apo njeriun e gjeografisë. E njeriu, nuk është njësoj në të gjithë botën, por është i ndryshëm. Ashtu siç ndryshon ambienti gjeografik në cilin është ngjizur geni i tij, atje ku ka origjinën, qoftë edhe atë të të parëve të tij. Është një kod që mbartet në shekuj, një kod që është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të ndryshojë dot. Pavarësisht përshatjeve, pavarësisht arsimimit e nivelit të kulturës që ai ka.

Punimi i gazetarit të mirënjohur Hitoaliajt në faqet e kësaj gazete, është një esse e stërmadhe, shumë përtej, edhe cakut të parametrave që kërkohen sot, për disertacionin në kërkim të gradës Doktor. Kjo ese e stërmadhe, i ka të gjithë elementët brenda. Edhe pse është studim mirëfilli shkencor, aty shpalosen

afhtësitë e shprehjes letrare të argumentit shkencor, si edhe guximi intelektual në opinionet e shfaqura.

Antropogjeografia ose Dhëshkronja njerëzore (Samiu kështu e quante gjeografinë), është degë fare pak e njohur në Shqipëri. Janë pak botime lidhur me gjeografinë njerëzore nga autorë shqiptarë e të huaj për Shqipërinë. Trajtimi më nënërytë të organizuar sipas koncepteve që jep Ratzel nuk është realizuar, por gjëra të vogla shfaqen të botuara veçmas nga autorë shqiptarë.

Mund të përmendet si botimi i hershëm që ka lidhje me këtë fushë, ai i Gaspër Gugës, i vitit 1909.

Ashtu siç meriton vëmendje Branko Merxhani, ky mendimtar i madh në botimet e revistës së tij, "Përplekja shqiptare". Ai ka trajtuar edhe antropogjeografinë e Ratzel-it si një disiplinë e re. Patqeqësisht, artikulli i tij mbeti një zë në shkretëtirë. Ndërkohë që ekziston një varfëri trajtimi nga autorë shqiptarë, të antropogjeografisë si e tërë dhe në përputhje me parimet raceliane, duhet thënë se studime që trajtojnë shqiptarët dhe Shqipërinë janë bërë nga të huajt.

Studimi më i kompletuar antropogjeografik, vjen nga studiuesi dhe biologu italian, Antonio Baldaçi. Vepra e tij "L'Albania", përbën studim antropogjeografik për Shqipërinë dhe shqiptarët. Analiza e tij shtrihet nga Iliria antike, e deri te pasardhësit e ilirëve, shqiptarët. "L'Albania" trajton strukturën gjeologjike të truallit shqiptar, natyrën e terrenit dhe format e veçanta të tij, brigjet, portet, faret, bimësinë, relievin, hidrografinë, lumenjtë, liqenit, klimën, bimësinë. Aty ai trajton antropogjeografinë shqiptare, zhvillimet historike shqiptare, kufijtë politikë dhe etnografikë, minoritetet dhe

kolonitë shqiptare.

Meqë synimi ishte shtrirja e influencës të Italisë përtej "mare nostrum", studimet e tij për Shqipërinë, janë mirëfilli radioskopia e interesave të kohës, në syrin e një studiuesi rigoroz. Hahn e Nopsca si pjesëtarë të elitës europiane, me studimet e tyre, ushqenin vizionin perëndimor për shtrirjen dhe komunikimin me rajonet pranë tij. Ami Boue qëndron përkrah tyre, ashtu si edhe Edith Durham e shumë të tjerë. Këta dhe studiues të tjerë, janë parë vetëm si albanologë prej shqiptarëve, por në të vërtetë studimet e tyre janë plotësisht për Shqipërinë e Shetit, natyrisht të shtetit të tyre. Edhe pse të vërtetat tona, ata i thanë me forcë. Merita e Dr. Hitoaliajt qëndron pikërisht këtu, se ai në studimin e tij kërkoi dhe arrin të shkojë, në gjenezë, aty ku u ngjiz bërthama e këtij kombi, trollin, me gjithë ç'përmban ai. E nga 420 burime që ka bibliografia e tij, vetëm 50 janë shqiptare. Ndoshta edhe për këto arsye, Profeshori tha se ky punim, duhet të jetë një libër në tavolinën e shtetit... **KAFKA, BEKIMI DHE MALLKIMI YNË...**

Kohët e fundit, Prof. Paolo Rognini, i departamentit të Shkencave Politike të Universitetit të Pizës, botoi rezultatin e një studimi të tij në revistën shkencore "Biological Theory".

"Po zbulojmë se kafka jonë mban pjesë të trurit që ende japin reageime antike, të cilat nuk i përshatën epokës ku jetojmë."

Në praktikë, kemi disa sjellje, mbetje nga reagimet arkaikë, që do të na bëjnë të shkatërojmë planetin e për pasojë veten tonë, duke realizuar kështu një version krejt të pazakotë të evolucionit, vetëshkatërimin e llojit. Truri ynë është "program rudimentar", i gjeneruar në fillim të historisë njerëzore, e që sot

nuk është i përshtatshëm për t'iu përgjigjur informacioneve të një ambienti krejtësisht të ndryshëm.

Jemi bartës të një sjelljeje grabitqare në raport me botën që na rrethon", thotë Rognini. Nuk mund të presim edhe 300.000 vite. Pra, vetëm duke modifikuar kulturën tonë, do mundemi të ruajmë qenien njerëzore", theksoi ai.

Nuk di nëse profesori i nderuar ka parasysh trurin e shqiptarëve, ashtu siç Baldaçi para një shekulli. Por nëse e ka fjalën për trurin e italianëve apo të njerëzimit në përgjithësi, do të thotë se ne jemi edhe më rëndë akoma.

Darvini, mbasi botoi Veprën e tij, deklaroi: "Sipas gjykimit tim, gabimi më i madh që kam bërë, është mosdhenia e rëndësisë së duhur, ndikimit të drejtëpërdrejtë të ambientit (truaillit ushqimit, klimës etj.), në mënyrë të pavarur nga fenomeni i selektimit natyral".

E prandaj anglezi Russell, në vitin 1874 kur kaloi këtej nga ne, shkroi: "Shqiptarët nuk kanë ndonjë besim apo adhurim të theksuar. Myslimanët shqiptarë i ndezin qirinj Shën Gjergjit dhe Shën Nikollës. Perëndia është për ta një genie e mëshirshme, e jo një natyrë eprore. Dhe perënditë mund të jenë të shumta, e njëra po aq e mirë sa edhe tjetra. Kjo shpjegon mosfanatizmin fetar, një tipar i dukshëm me sy të lirë në Dalmaci dhe në Shqipëri. Kështu shpesh herë është e vështirë që të merret vesh nëse një banor është i krishterë apo mysliman".

Kurse "Hylli i Dritës" i vitit 1944, sjell përshkrimin domethënë të mbijetesës së genies sonë: "Shkambij të gjallë, shkrepë të lamë, curra të zdheshun, fortesa e gjithmonshme e një fisit kreshnik. Shkambi e lindi dhe e ushqeu, e shkambi i rrujtë n'gjij të vet të mbetat e tija. Iliri leu roje e vdiq roje e shkambit-babë; konglomerat shpirti dhe guri. E kur në shekullin e XIX, kerkuesat e mbeturinave të qytetnimeve të perendumeve banë apelin e popujve të vdekur: "Jam këtu!"-ushtoi nji za prej brigjeve t'Adriatikut: "Këtu jam!"-përsëriti jehona neper qandrat e jetës s'Europës së qytetnueme. E zani qj delte shi prej Prizrenit, tingëlloi n'atë Berlinin e famshëm, ku trashgimtarë të rrejshëm dojshin me pervetsue tokat ilire. Iliri nuk ka vdekë, asht gjall nder krepat e maleve, nder shpellat e bjeshkvet, nder humbernat e luginave, e pa vdekë unë,

kërkuji nuk i trashëgohet e drejta e pronsis!".

Autori Hitoaliajt, duke krahasuar ekzistencën shtetërore shqiptare pas rënies së perandorisë osmane, me periudhën e pas viteve '90, arrin në konkluzionin se... "Shqiptarët ndërtojnë atë, 'shtetin e lashtë' të tyre, i cili ka mbizotëruar gjithnjë mes shqiptarëve, në çdo rast kur ka pasur liri e mungesë administrimi nga perandoritë pushtuese, apo kur sistemi bie"...

...Doktor Hitoaliajt ishte i vetmi gazetar që pati Shtypi i Forcave të Armatosura në vitin jo aq të largët - 2013. E pikërisht për këtë arsye, "menaxherët" e Mbrojtjes e përzunë me pretendime idioti! Emëruan një individ në prag pensioni, për të pasur pagën e lartë, mblodhën edhe ca hallexhinj për ditën e punës, kuptohet, të përgjedhur edhe me kriteret regionale e religjioze. Asnjëri gazetar, ndër ta. Alberti do fitojë edhe gjyqin e shkallës së dytë e do marrë pagat. Ashtu siç gjeneralbrigade Vladimir Qiriazit mori këtë ditë, të gjitha pagat, qysh nga 16 dhjetori i 2011-ës e këtej, e do të vazhdojë të marrë pagën e plotë të gjeneralit, derisa të mbushë moshën e pensionit. Sepse ashtu iu tek ishi "menaxherit" të asaj kohe, emri i të cilit nuk më kujtohet. Pasi gjenerali nuk kishte firmosur privatizimin e Klubit "Partizani", e të disa objektive të tjera me rëndësi strategjike... Por rrogat merren dyfish; një ai i ndjekuri, e një ky që është në detyrë.

Albert Hitoaliajt sot hijeshon me ditjet e tij, Akademianë e Rendit, e cila mori edhe Sigurinë. Sektori i Sigurisë në atë Akademi u ngrit me materialin njerëzor dhe intelektual të Akademisë së Mbrojtjes, i cili u përzua nga aty ku kishte folenë e tij të kahershme. Dhe mirë u veprua që u rihap, atje, në shtet.

Në sytë e njerëzve të shumtë që erdhën nga Akademia e Rendit në mbrojtjen e Doktoraturës së Albertit lexohej qartë gëzimi, e pse jo, edhe krenaria. Sepse ata kanë tre vjet, që e kanë lektor në auditorë dhe gjenerator në botimet e tyre. Kurse tek udhëheqësi i temës, Prof. dr. Pajtim Ribaj, krenaria ishte legjitime.

...Nuk di nëse Prof. Paolo Rognini ka parasysh trurin e shqiptarëve, ashtu siç bashkëtdhetari i tij, Antonio Baldaçi para një shekulli. Por nëse e ka fjalën për trurin e italianëve apo të njerëzimit në përgjithësi, kjo do të thotë se ne jemi edhe më rëndë akoma...

Kryeministri kosovar: Bashkohuni siç e bëtë për ushtrinë e FSK

Haradinaj i drejtohet parlamentit për marrëveshjen me Serbinë: Ju lutem veproni!

Një reagim lidhur me dialogun me Serbinë e ka pasur edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës. Ditën e djeshme Ramush Haradinaj ka kërkuar që edhe për çështjen e dialogut me Serbinë të arrihet i njëjti konsensus që u arrit në ditën e votimit të paketës së ligjeve për shndërrimin e FSK-së në ushtri të Republikës së Kosovës. Ai ka lutur deputetët që nëse e gjejnë një konsensus të tillë, të veproni. Sipas Haradinajt, patjetër do të vijë një ditë kur do të duhet të gjendet një kompromis edhe për çështjen e dialogut. "E para është interes kombëtar që për çështje të interesit të përgjithshëm sh-

tetëror dimë të gjejmë gjuhë të përbashkët. Por s'do ta kemi problem në çfarëdo etape, pa e gjetur ndonjë formulë për çështjet e interesit nacional. Mendoj që njëra prej temave që kemi nevojë është çështja e dialogut me Serbinë", ka thënë Haradinaj. Ai thotë se për çështje të tilla dhe marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të vendosë askush tjetër përveç Kuvendit të Republikës së Kosovës. "Nuk ka dilemë që Kuvendi i Kosovës është autoriteti suprem pa të cilin asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të jetësohet jetësua. Vetëm



parlamenti mund të marrë vendime të tilla", ka thënë kryeministri. Haradinaj ka bërë thirrje që të gjendet një kompromis në këtë çështje.

RAMUSH HARADINAJ
"Do t'i lutesha parlamentit që të gjejmë një moment të tillë për një situatë nacionale nëse ekziston. Rrugëtimi i dialogut po na kthehet si kompromis, por të mos harrojmë se themelet e kompromisit i kemi në Kushtetutën tonë në paketën e Ahsitarit, që na ka bërë këta që jemi. Nëse mundeni të gjejmë një moment të tillë, ju lutem veproni", ka thënë Haradinaj.

"Do t'i lutesha parlamentit që ta gjejmë një moment të tillë për një situatë nacionale, nëse ekziston. Rrugëtimi i dialogut po na kthehet si kompromis, por të mos harrojmë se themelet e kompromisit i kemi në Kushtetutën tonë në paketën e Ahsitarit. Vetëm zbatimi i atyre kompromiseve më të hershme është një kompromis për Kosovën. Paketa e Ahsitarit na ka bërë këta që jemi. Nëse mundeni të gjejmë një moment të tillë, ju lutem veproni", ka përfunduar kryeministri Ramush Haradinaj në fjalën e tij para deputetëve.

Veseli: Vizat vonohen 1 vit, është mundim të takohesh me serbët

Kufiri Kosovë-Serbi, Thaçi dhe Brnabiç takohen në Bjellorusi

Brnabiç: Vijat e kuqe gjermane vështirësojnë marrëveshjen

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka biseduar ditën e djeshme me kryeministren e Serbisë, Ana Brnabiç, në një konferencë për sigurinë në Minsk të Bjellorusisë, raporton agjencia serbe e lajmeve "Beta". Sipas burimit të njëjtë, Brnabiç tha se është biseduar për përpunimin në dialogun Beograd-Prishtinë dhe se ajo ka shfaqur shpresën se do të arrihet deri në një marrëveshje, që do të çojë në një stabilitet më të madh të rajonit. Ministri i Jashtëm bjellorus, Vladimir Makej, u tha gazetarëve se Brnabiç dhe Thaçi gjatë takimit në Minsk, disa herë kanë përdorur fjalët "dialog" dhe "kompromis". "Edhe ky takim është i rëndësishëm. Palët shprehin gatishmëri për dialog dhe dialogu, sipas qëndrimit të Bjellorusisë, është mënyra e vetme për zgjidhjen e të gjitha problemeve", tha shefi i diplomacisë bjelloruse. Ndërkaq, kryeministria e Serbisë, Ana Brnabiç, gjatë qëndrimit të saj në Minsk të Bjellorusisë ka folur për arritjen e një

VLADIMIR MAKEJ
"Edhe ky takim është i rëndësishëm. Palët shprehin gatishmëri për dialog dhe dialogu, sipas qëndrimit të Bjellorusisë, është mënyra e vetme për zgjidhjen e të gjitha problemeve", tha shefi i diplomacisë bjelloruse.



Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi

ANA BRNABIÇ
"Beogradi është i përkushtuar për dialogun dhe gjetjen e një kompromisi nëpërmjet dialogut. Qëndrimi i Gjermanisë kundër idesë për korrigjim të kufijve, vijave të kuqe e vështirëson dialogun me Kosovën".

misionarin e BE-së, Johannes Hahn, me të cilët ka diskutuar për fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi dhe gjithashtu edhe për liberalizimin e vizave për Kosovën. Nga ana tjetër, Kadri Veseli, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, si dhe kryetar i Kuvendit të Kosovës deklaroi ditën e djeshme se liberalizimi i vizave mund të shtyhet edhe për një vit. Në "Debat Plus" Veseli tha se qytetarët kosovarë duhet të besojnë tek BE-ja. "Jam nga njerëzit më kritik, por unë i besoj BE-së. Kam për t'i besuar gjithmonë, sepse me të kemi arritur deri këtu. Edhe pse mund të na kushtojë edhe një vit pa liberalizim të vizave, me kohë do të fitojë arsyeja. Nuk ka inate, nuk ka hatërmbetje, futu në proces dhe mendo për generatat e ardhshme. Nuk është hejz të takohesh me Serbinë, është mundim", tha ai.

marrëveshjeje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo ka thënë se rezultati i dialogut Prish-

GJKATA MERR VENDIM PËR KAMERAMANEN QË SHKELMONTE REFUGJATËT

Nëpër rrjetet sociale u bë viral xhirimi i një skene ku shihej një kameramane hungareze, duke rrëzuar dhe duke shkëlmuar imigrantët, teksa ata iknin prej policisë afër kufirit Hungari-Serbi, në shtator të 2015-ës. Megjithatë, Gjykata Supreme Hungareze të martën e ka liruar Petra Laszlon.



FOTOLAJM

tinë-Beograd në Bruksel duhet jetë një zgjidhje e qëndrueshme për çështjen e Kosovës. "Beogradi është i përkushtuar për dialogun dhe gjetjen e një kompromisi nëpërmjet dialogut", ka thënë ajo, transmeton gazeta "Express". Kryeministria serbe është shprehur se dialogu nuk është një proces i lehtë, por e vetmja mënyrë për stabilizimin afatgjatë të raporteve Kosovë-Serbi. Ajo ka folur edhe për qëndrimin e Gjermanisë kundër idesë për korrigjim të kufijve, duke thënë se vendosja e vijave të kuqe e vështirëson dialogun. Në takim merr pjesë edhe Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Ai është takuar me ambasadorin gjerman, Wolfgang Ischinger dhe ko-

SHKURT

Alarm në Francë, 2000 makina bllokohen në rrugë

Një kaos i madh është shkaktuar në Francë për shkak të motit të keq, ku rreth 2000 mjete janë bllokuar gjatë natës përgjatë rrugës të lumit Loira për shkak të dëborës së madhe që ka rënë. Shumë shtëpi kanë mbetur pa energji elektrike. Ata që u bllokuan nga dëbora me makinat e tyre kanë preferuar të lënë mjete në rrugë dhe të largohen në këmbë në zonat më të afërta. Rreth 1250 mjete të rënda dhe 700 vetura kanë mbetur të bllokuara për shkak të dëborës që ka mbushur rrugët në një kohë shumë të shkurtër. Dëmet e shkaktuara nga shiu dhe dëbora janë të mëdha.

E merrshme! Infermieri pranon se ka vrarë 100 pacientë

Në ditën e parë të gjyqit kundër tij, një ish-infermier gjerman ka pranuar se ka vrarë 100 pacientë në qytetin gjermano-vepor të Oldenburgut. Detektivët thonë se 41-vjeçari Niels Hogel u dha doza fatale ilaçesh pacientëve nën kujdesin e tij, në dy spitale në veri të vendit. Arsyeja pas këtij veprimi sipas ish-të dëshira e tij për të lënë përshtypje tek kolegët duke "ringjallur" të njëjtët pacientë. Ai akuzohet se ka vrarë 36 pacientë në Oldenburg dhe 64 në Delmenhorst mes viteve 1999-2005. Kur u pyet në gjykatë nëse akuzat ndaj tij ishin të vërteta, Hogel pohoi të kishite vrarë "pak a shumë" të njëjtin numër. Kjo e bën 41-vjeçarin vrasësin serial më të madh në Gjermaninë e pasluftës. Hogel u arrestua në vitin 2005, pasi u kap duke i injektuar doza të parekomanduara një pacienti në Delmenhorst. Në vitin 2008, ai u dënua me 7 vite burg për vrasje në tentativë. Në vitin 2014-2015, një tjetër gjyq e gjeti fajtor për dy vrasje të tjera në tentativë, duke e dënua me dënim të përjetshëm. Provat e reja tashmë e përfshijnë ish-infermierin në vrasjen e 100 pacientëve të tij.

Alarm për bombë pranë gjykatës së Athinës, evakuohen banorët

Alarm për bombë pranë gjykatës së Athinës. Ka qenë një telefonatë e një personi që ka ngritur në këmbë policinë. Kjo e fundit ka evakuuar banorët pranë gjykatës. Kujtojmë se pak ditë më parë në Athinë policia u alarmua pas një pakaje të dyshimit që u gjet pranë një bankomati. Pavarësisht se u dyshua për bombë, fatmirësisht nuk rezultoi të ishte ashtu.

Largohen prej tri dekadash, ja arsyet e braktisjes së vendlindjes nga shqiptarët

Alarm ndërkombëtar/ Shqipëria, e para në Europë dhe e pesta në botë për emigracion

MARRË NGA "DEUTSCHE WELLE"

Shkollimi dhe perspektiva më e mirë e jetës. Kjo është dëshira e shumë shqiptarëve, që për ta realizuar një gjë të tillë synojnë largimin nga Shqipëria.

DW: Prof. King, cila është situata e emigrimit potencial nga Shqipëria drejt vendeve të Europës Perëndimore, SHBA apo Kanada? Ju keni drejtuar studimin e sapopublikuar në Tiranë, "Trende të reja në emigracionin potencial nga Shqipëria", të Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale, mbështetur nga Fondacioni Friedrich-Ebert. Pra, farë tregojnë gjetjet e këtij studimi?

Russell King: Gjetjet tregojnë që emigrimi i shqiptarëve vazhdon, që prej afër 30 vitesh. Por natyra e tij po ndryshon, nuk është më një dukuri për arsye ekonomike apo politike, por një dukuri që po prek të gjitha shtresat e shoqërisë, grupmoshat, klasat e ndryshme shoqërore për nga të ardhurat. Emigrimi potencial është rritur në vitin 2018 në 52% nga 44% që ka qenë në 2007. Studimi tregon se tendenca më e fundit është ajo e emigrimit të njerëzve që kanë mbaruar universitetin, i rinisë së kualifikuar në nivel të lartë, që ka dëshirë të madhe të emigrojë. 57% e grupmoshës 18-40 vjeç synojnë të emigrojnë. 46% e atyre që nuk kanë emigruar asnjëherë synojnë të emigrojnë. 72% e emigrantëve të kthyer, pra e atyre që kanë qenë njëherë në emigracion, dëshirojnë të ikin përsëri. Për shkak



të krizës financiare në Greqi në 2008-ën dhe Itali, rreth 134 mijë emigrantë në këto dy vende fqinje u detyruan të kthehen në Shqipëri, sepse humbën vendet e punës. Rreth 1.4 milionë vetë, pothuajse gjysma e popullsisë së tanishme të Shqipërisë, ka emigruar në Europën Perëndimore, SHBA dhe Kanada, që nga rënia e regjimit komunist në 1991 e deri më sot.

DW: Cili është raporti mes emigrantëve të kthyer në Shqipëri dhe atyre që nuk kanë qenë asnjëherë emigrantë, por synojnë tani të ikin?

Russell King: Është vështirë të dihet ky raport. Statistikat në Shqipëri për

emigracionin nuk janë shumë të qarta, nuk regjistrohet me saktësi në baza vjetore numri i njerëzve që ikin dhe i atyre që kthehen. Por është e qartë se që prej 1991 numri i shqiptarëve që ikin është shumë më i madh se numri i atyre që kthehen. Dëshira për të emigruar është shumë më e madhe tek ata që kanë qenë një herë emigrantë dhe janë kthyer, sesa tek ata që nuk kanë emigruar kurrë. Tendenca është që kush ka emigruar një herë, dëshiron shumë të emigrojë përsëri. Numri i përgjithshëm i popullsisë po bie, Shqipëria po tkurret.

DW: Pse dëshiron më shumë se gjysma e popull-

sisë të ikë? Çfarë arsyesh janë gjetur në studimin që keni drejtuar?

Russell King: Studimi tregon se një nga arsyet kryesore pse njerëzit duan të ikin është se nuk shohin të ardhme për vete dhe fëmijët e tyre në Shqipëri. Pjesa më e madhe kërkojnë një shkollim më të mirë për fëmijët e tyre. Vendet e preferuara janë Gjermania dhe SHBA. Arsyet tjetër kryesore janë të ardhurat shumë të ulëta në Shqipëri, kur kosto e jetesës sa vjen e ngrihet. Është normale që njerëzit në Shqipëri të duan të eksplorojnë mundësi për të fituar të ardhura më të mira. Është ky grup faktorësh: të ardhura të ulëta,

pakënaqësi nga arsimi i lartë, perspektiva të vaktave pune, mungesa e perspektivës për brezin e ri, që vazhdojnë të ekzistojnë duke e bërë Shqipërinë të zërë vendin e parë në Europë dhe të pestin në botë për dëshirën e madhe për të emigruar - në bazë të një studimi të IOM (International Organization for Migration). Që kjo situatë të ndryshojë lypsen politika zhvillimi që krijojnë në shumë mundësi punësimit dhe të ardhura të mira.

DW: Shqipërisë po i ikën rinia që ka dijet, energjinë, vullmin për ndryshim. Si mund të ndalet ikja e rinisë?

Russell King: Po, e drejtë. Shqipërisë po i ikën truri, po i ikin përvoja dhe kualifikime të nivelit të lartë. Por kjo dukuri nuk po ndodh vetëm në Shqipëri, por në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Europën Lindore. Pasoja të bëhen edhe më të rënda nga kombinimi i ikjes me rënien e numrit të lindjeve. Gjithsesi, nëse zhvillimi ekonomiko-social në Shqipëri ndodh në drejtimin e duhur, ai mund të ndalojë rininë të emigrojnë. Industria e Turizmit ofron mundësi për rininë, jo domosdoshmërisht për ata që kanë kualifikime të nivelit të lartë si doktorë, juristë etj., por për ata që kanë kualifikime të nivelit të mesëm, që kështu manifaktura, sektori bankar, fi-

nanciar, menaxhimi, arsimi i lartë. Por duhet ngritur një sistem meritokracie transparence në emërimet, që mungon në Shqipëri, duhen përmirësuar standardet e rekrutimit në tregun e punës. Shqipëria ka burime për t'u zhvilluar, nëse ato përdoren si duhet.

DW: A e favorizon situata në Europë dhe në botë dëshirën e shqiptarëve për të emigruar, pra kalimin nga emigracioni potencial në atë real, nga dëshira tek realizimi i saj?

Russell King: Po, e favorizon. Nëse shohim skenarin global të emigracionit, shumë vende kërkojnë emigrantë me përvojë profesionale. Kanadaja, Australia etj., kanë politika emigrimi që tërheqin njerëzit me përvojë të nivelit të lartë në disa sektorë të ekonomisë. Të rinjtë dhe të rejtat e Shqipërisë, që kanë nivel të lartë njohurish, gjejnë punë në këto vende. Shqipëria humbet rininë e saj të kualifikuar, për të cilën ajo ka investuar vite të tëra, e cila kur ikën kontribuon jo për vendin e saj, por për vendet ku emigron. Kjo është rrjedhja klasike e trurit, që mund të ndalojë.

Prof. Russel King, në Shkollën për Studime Globale, në Universitetin e Sussex në Britaninë e Madhe është Drejtor i Qendrës Sussex për Kërkime mbi emigracionin, e njohur në të gjithë botën.

E mbipopulluar prej muajsh, shpërngulen emigrantët nga Bosnja

Flinin rrugëve, dhjetëra autobusë transportojnë aziatikët e afrikanët nëpër kampe

20 MIJE EMIGRANTE

Prej fillimit të vitit, Bosnja po strehon mbi 20 mijë emigrantë nga Iraku, Irani, Siria, Pakistani, Afganistani, të cilët përmes rrugës ballkanike që kalon edhe nga Shqipëria synojnë vendet e Bashkimit Europian.

aturave. Megjithatë, shumë prej tyre nuk duan të zhvendosen në kampe. Skena të tilla përlëshjesh

me policë që i pengojnë të kalojnë kufirin me Kroacinë janë bërë të zakonshme. Banorët vendës

kanë protestuar shpeshherë, pasi ata janë shndërruar në shqetësim për sigurinë e tyre. Ata janë autorë të dhjetëra rasteve të vjedhjeve e ngacmimeve seksuale. Autoritetet ankojnë se nuk kanë kapacitete pritjeje. Teksa Bashkimi Europian nuk u ofron zgjidhje konkrete veç fondëve për strehimin e tyre. Prej fillimit të vitit, Bosnja po strehon mbi 20 mijë emigrantë nga Iraku, Irani, Siria, Pakistani, Afganistani, të cilët përmes rrugës ballkanike që kalon edhe nga Shqipëria synojnë vendet e Bashkimit Europian.



Ditën e djeshme autoritetet boshnjake kanë nisur shpërnguljen e qindra emigrantëve afrikanë e aziatikë nga qyteza veriore e Bihacit, e mbipopulluar prej muajsh prej tyre, me shpresën për të kaluar kufirin kroat drejt vendeve të zhvilluara europiane. Me dhjetëra autobusë po mbushen çdo ditë për t'i dërguar emigrantët që flenë rrugëve, në kampe të ngritura posaçërisht për akomodimin e tyre. Autoritetet morën masa pas alarmit të ngritur nga Kombet e Bashkuara për një tragjedi të mundshme humanitare, prej rënies së ndjeshme e temper-

KONFERENCA SHKENCORE

Qyteti minator i Selenicës në Vlorë gjatë komunizmit

Nga Natasha Llanaj Perpunja

Ai kemi njohur ne brezat me sakrificat e prindërve dhe gjyshërve të tyre, me kalvarin e vuajtjeve për mbijetesë në një nga vendet me diktaturën më të egër? Sigurisht që ne të gjithë kemi një bilanc, por a ka qenë ky i mjaftueshëm? Unë them se jo, jemi të vonuar. Kam shfletuar qindra faqe dokumentesh, ku në mënyrë rrëqethëse pasqyrohet mizoria e atij regjimi që burgosi, pushkatoi, dëboi dhe internoi shumë familje nga vatrave të tyre. Vetëm në vitin 1983 sipas disa vendimeve të Komisionit të Dëbim internimeve, janë dëbuar dhe internuar qindra familje dhe individë. /*Dosja 250 dhe 251, lista e dëbim-internimeve/.*

Kampet e izolimit ose kampet e hapura si Selenica dhe shume zona të thella të Vlorës dhe të Shqipërisë nuk mund të krahasohen me burgjet e Spaçit dhe të Burrelit ku humbën jetën dhe rininë e tyre shume nga elitat e kombit, por ishte një jetë e vështirë nën vëzhgimin mbyjtës të sigurimit të shtetit. Në çdo hap të jetës që do të bëjë do të duhej miratimi i organizatave të Partisë, do të duhej miratimi i operativit të sigurimit. Edhe për të shkuar në spital në Vlorë do të merrje lejen e operativit, nuk mund të takoje dhe të merrte pjesë në gëzimet dhe fatkeqësitë e të afërmeve, miqve sepse do të krijonte problem edhe për ata. Selenica është një qytet i vogël minatorësh me një nga minierat më të vjetra të Shqipërisë, me serën e së cilës ishin shtruar rrugët e Europës, por 36 kilometrat e saj për në Vlorë nuk ishin shtruar kurrë. Qyteza mbledhte punëtorë edhe nga fshatrat përreth. Vështirësia e punës në minierë, tymi dhe blota e zezë e shkrirjes së serës shkatërronin mushkëritë ju vetëm të minatorëve që nuk i kalonin të 60-tat, por të gjithë qytetarëve. Ekonomia familjare ishte shumë e varfër, ende i kam para syve fëmijët e vegjël duke trokitur tek njëri-tjetri për një lugë salcë apo një filxhan vaj, apo si e ndanin rrogën me njëri-tjetrin, kush e merrte i pari, dhe kështu qarkullonte në gjithë lagjen deri sa vinte rroga tjetër dhe shlyenin borxhet. Një varfëri që e kemi ndër të gjithë. Këtyre pamjeve, ju shuan netëve në errësirë edhe ardhjet e familjeve që kishin lënë të detyruara shtëpitë dhe vatrave të tyre. Nëpër mend më kalojnë dëshmitë e gjalla të familjeve të para të ardhura në këtë qytet të dëbuar dhe të ndëshkuar padrejtësisht nga regjimi, familja Murtaç, Xhaferaj një familje me djem të talentuar që kontribuuan dukshëm në jetën e qytetit si piktorë dhe duarartë, por që nuk patën fatin që fëmijët e tyre të shkollonin me arsim të lartë. Esh-



Përndjekja, persekutimi, tymi dhe blota e zezë e shkrirjes së serës

të një nga pengjet që mund të ketë jo vetëm prindi dhe fëmija, por edhe shokët dhe mësuesit e tyre për këtë ndalim në arsimimin e tyre.

DOSJA XHEHAL NDREU

Një familje me 70 anëtare pasi Cen Elezi doli në mal si kundërshtar i qeverisë komuniste filloi një kalvar i vërtetë vuajtjesh, burgosjesh dhe internimesh për këtë familje. Xhehal Ndreu kishte bërë Shkollën Teknike ku drejtor ishte Hari Fultz dhe me shpresën se pushteti komunist do të binte dhe do të ndërtohej një shtet perëndimor që bashkëpunojnë me anglo-amerikanët. Të tjerë vëllezër nga frika e arrestimeve tentojnë të arratisen, por nuk mundën t'u shpëtojnë arrestimeve dhe dënimeve. U konfiskohet pasuria dhe fillojnë dëbim-internimet e tyre në Berat,

Tepelehtë, Valias, Porto Romano, Kripore, Sevaster, Xhuherinë, Llakatund, Lubonja. Djemtë e kësaj familjeje bëjnë të gjithë së bashku rreth 130 vjet burg. Një familje që pësoi një kalvar vuajtjesh dhe persekutimesh në burgje, kampe dhe zona të thella. Pa asnjë të drejtë shkollimi të lartë, edhe pse ishin nxënës të shkëlqyer që do ndiqeshin dhe përndiqeshin në çdo hap edhe në bankat e shkollës me denigrimin si armiq të pushtetit. Edhe sot është në kujtesë reagimi i shokëve që e donin Cezar Ndreun, shokun e tyre, ndaj mësueses kandidatë Partie që e denigronte hapur si djali i një familjeje armike të popullit. Gjithçka bëhej në emër të popullit, fatkeqësisht.

FAMILJA HASANAJ



Natasha Llanaj Perpunja

tisë shumë njerëz për të ndjekur çdo veprim, çdo fjalë të këtyre njerëzve dhe të informonin operativin.

Varfëria dhe frika e arrestimit dhe dëbimeve mbizotëronte kudo, por me gjithë këtë, kam një mirënjohje për njerëzit e thjeshtë të këtij qyteti që në mënyrë të ndryshme herë heshtur dhe herë me guxim dinin si të gjendeshin pranë.

Sa më shumë varfërohej vendi, aq më e egër bëhej lufta e klasave dhe thellohej ndarja. Hije që kanë lënë gjurmë edhe sot në shpirtat e të gjithë njerëzve. Pasi burgosi, pushkatoi dhe përndoqi e dëboi nacionalistët, pronarët, elitën e shkolluar në Perëndim, familjet e tyre, Partia-shtet do ta mprehte shpatën për bijtë e vet. Filloi lufta e egër brenda Partisë, filluan burgosjet internimet me familjet e tyre, shumë familje erdhën në këtë qytet. Familja e Pajo Islamit, familja Jakova, familja Belishova, Frasherit, Dermani, Ngjela, Hoxha, Dumi, Kerexhi, Dishnica, Mamaqi, Dermani, Kruja, Cako, Themeli, Bedri Spahiu, Balluku e shumë e shumë të tjerë. "**Gazet 69**", *makinat e Sigurimit* që vinin ditën e natën, arrestonin e sillnin të tjerë. Të gjitha këto reflektonin frikë dhe ankth në gjithë qytetin. Një pjesë e këtyre njerëzve më parë në poste të larta shtetërore ishin përgjegjës dhe vendimarrës të burgosjes dhe internimeve dhe kalvarit të vuajtjeve të të persekutuarve antikomunistë. Një pjesë panë dhe prekën nga afër se ëndrrat e tyre për një shtet të drejtë ishin një iluzion, një pjesë edhe reaguan. Dënimi, burgosja, dëbimi dhe poshtërimi i tyre do të ishte po aq i egër nga Partia e tyre sa edhe të tjerëve antikomuniste më parë.

Ruheshin këta nga kontaktet me njerëz, ruheshin njerëzit nga kontaktet me ta dhe rituali i paraqitjes së përditshme tek operativi i degës.

Qytetarët e kuptonin ardhjen e tyre nga lëvizjet e sigurimit, bëheshin gati shtëpitë e tyre me aparaturat e përgjimit dhe në mesnatë ishin aty.

Kishte pamje nga më të ndryshmet në qytet, frikë dhe ankth për të nesërmen. Skërmitje dhëmbësh, mbledhje për forcimin e vigjilencës së Partisë, kinezëria me nxënës shkollash duke kaluar para shtëpive të tyre duke bërtitur në kor "Parti/Enver"! Varfëria rritej çdo ditë dhe njerëzit që prinin me shpresë, antikomunistët e parë që merrnin zemër dhe thoshin me njëri-tjetrin se po i vjen fundi këtij regjimi, gjithçka mendonte ai qytet. Do të ishte gjest ju vetëm i mirëpritur moral, por reflektimi i tyre do të besohej duke u larguar nga çdo hallke dhe qelizë shtetërore që mund të jenë, do të bashkëpunonin për gjetjen edhe të eshtrave të shumë viktimave të pafajshme ku familjarët e gjenocidit komunist të kishin një varr

Kampet e izolimit ose kampet e hapura si Selenica dhe shume zona të thella të Vlorës dhe të Shqipërisë nuk mund të

krahasohen me burgjet e Spaçit dhe të Burrelit ku humbën jetën dhe rininë e tyre shume nga elitat e kombit, por ishte një jetë e vështirë nën vëzhgimin mbyttës të sigurimit të shtetit.

për të ngushëlluar familjarët e tyre. Në brezin e dytë të të internuarve nga radhët e Partisë, përveç refleksionit ndaj të persekutuarve antikomuniste, bie në sy një element tjetër, ata nuk pranojnë të quhen armiq të popullit, *armik i partisë po*, do të shprehej Pajo Islami apo Dashnor Mamaqi.

Në dosjen 12552/A të hetuesisë dhe gjykimit të Dashnor Mamaqit, 22 dhjetor 1975, lexojmë: "Unë kam pasur pikëpamje të kundërta me Partinë në drejtim të luftës së klasave. Nuk kam qenë dakord me Partinë se në socializëm, lufta e klasave nuk shuhet... Nisur nga kjo pikëpamje unë gjatë gjithë kohës kam mbajtur qëndrim të pajtimtë dhe të afërmim me elementet të damkosur e armiq, duke i marr këta në mbrojtje nga goditjet që u bëheshin.....".

DOSJA PAJO ISLAMI

Pajo Islami, një nga figurat qendrore të Partisë që do të kishin fatin e shumë dhe shumë njerëzve të tjerë që u burgosën dhe u internuan.

Në Konferencën e Tiranës ai do shprehej kundër kultit të individit dhe do të shprehte zhgënjimin e tij për udhëheqjen e Partisë, privilegjet e familjarëve dhe indiferentizmin ndaj kushteve të vështira të punës dhe jetesës së punëtorëve. Do të dehohej familja e tij në disa vende, Lubonjë, Selenicë etj. Duke shfletuar në dosjen e tij sheh se kudo ku shkonte kishte një njeri mbrapa, operativ i instruktonte njerëz të ndryshëm të rrethit edhe miqësor dhe shoqëror, shokë pune, shofer, që do ta ndiqnin. "Një do të thoshte e takova para disa kohësh tek Banka dhe më tha, që përshajtimi yt nga Partia nuk është i drejtë./një dëshmitar: "Një tjetër do të informonte e takova tek hotel "Dajti" dhe më tha si e kish kundërshtuar Adil Carcanin". Një tjetër do ta ndiqte edhe kur dilte me familjen deri tek kodra dhe do të informonte... Një makinë e tërë njerëzish mbas një njeriu, kjo është një dëshmi për funksionimin e gjithë të dëbuarve dhe njerëzve të lirë në thonjëza dhe jo të lirë.

Ky ishte qyteti im, në kohën e diktaturës.

"Kumtesa në konferencën "Të mohuar nga regjimi"

PREMIERA

"I MASKUARI"

Ben Derhemi: "Turbina" pallat sporti, jo skenë Teatri

Fatmira Nikolli

Vepra më e re që vjen premierë këtë fundjavë titullohet "I Maskuari" dhe në subjektin e saj trajtohet një familje e copëtuar nga mashtrimi, tradhtia dhe lufta. Nga të gjitha plagët e shkaktuara nga lufta moderne guerrile, ajo që lë ndoshta plagët më të thella emocionale është ajo e familjeve të shkatërruara nga besnikëritë konfliktuale, duke zëvendësuar dashurinë familjare dhe besimin me dyshimin dhe mosbesimin. Tek "I Maskuari", një shfaqje e fuqishme nga Ilan Hatosor, janë tre vëllezër palestinezë, që janë të mbërthyer në një luftë për jetë a vdekje për shkak të mashtimit dhe tradhtisë. Ngjarja është e vendosur në një fshat palestinez në bregun perëndimor në vitin 1990, por historia e saj mund të ketë ndodhur në të njëjtin mënyrë në një numër qytetesh gjatë 20 viteve të fundit nga Belfasti deri në Johannesburg, në Sarajevë, apo edhe në Bagdadin e sotëm, kudo ku një forcë ushtarake ka vënë vëllanë kundër vëllait. "Maskuari", një shfaqje e fuqishme nga Ilan Hatosor vjen premierë në datat 31 tetor-1-2-3-4 nëntor ora 19:00 salla 'Moliere'.

Regjisori Milto Kutali tha se, "sjellim një nga veprat më të rëndësishme të këtyre 20 viteve të fundit". Mbi 100 vënie skenike në Amerikë e Europë. "Shfaqja ka ngjallur interes publik dhe ka arritur të komunikojë me skutat e qytetave të vogla në mbarë botën. Është përpjekje prej tri vitesh kur Eda Derhemi e shqipëroi. Një dramë e tre vëllezërve palestinezë që përballen me njëri-tjetrin, kur pyet dhuna e përgjigjet dhuna. Ata shkojnë deri në ekstrem. Ne menduam që ky realitet përfaqësojë edhe me realitetin tonë, edhe pse ne tentojmë të ndërtojmë një shoqëri të hapur, e sjellim si thirrje për të thënë se gjithçka është njeriu e çdo gjë duhet bërë për njeriun", tha ai. Regjisori Kutali e cilësoi kast të mrekullueshëm aktorësh bashkëpunimin me Ben Derhem. Alfred Trebickën dhe Ismail Shino.

DEKLARATAT

I pyetur pse e vë shfaqjen te "Eksperimentali" dhe jo te "Turbina", aktori Arben Derhemi tha se, "ar-Turbina është pallat sporti, jo skenë Teatri. Më vjen keq ta pohoj, po ashtu është. Dhe të gjithë kemi të njëjtin mendim kam përshtypjen. Pastaj ka edhe një dashamirësi të një njeriu që ka dashamirësi për teatrin në tërësi. Në bashkëpunim me njerëz që e duan teatrin, jo e njerëz që i kanë shpallur luftë teat-



Konferenca për shfaqjen e deklaratat për artin e cilësinë artistike

rit". Megjithatë, ai pranoi se kur ta dojë puna, do luajë edhe te "Turbina" si pjesë e trupës së Teatrit Kombëtar. "Janë detyra që duhet t'i bëjë çdokush. I keni parasysh detyrat e burrit dhe gruas në shtëpi? Do të dal të këndoje edhe në pallat të sporteve herë pas here, kur të kem punë. Kemi pas ca fusha të zeza në kohë të komunizmit. Ishin me qymyr, të zeza dhe ne luanim aty futboll. Kush është ai që s'do të luajë futboll në palestër, por ne luanim futboll edhe aty", tha Derhemi.

Trebicka shtoi se kjo është përtej veprës. "E kam thënë vazhdimisht, që produkti teatror këtu te ne ka shumë probleme të karakterit profesional. Cilido mund të bëjë teatër e të dalë në skenë e të quhet aktor. Shohim vepra e lexojmë vepra dhe nuk i gjejmë në skenë atë aktor e atë veprë. Ti lexon Don Zhuanin dhe kur shkon aty e sheh Meremen, çuditësh. Le t'i vënë emrin idesë që kanë, pa e shitur si Don Zhuan. Produkti ka shumë problem, se nuk ka institucione që bëjnë rregullimin e kësaj gjëje. Kemi një virozë që këtu mund të hipë çdo njeri në skenë e të dalë kushdo. Po ngatërrohen gjellët. Si të marrësh biftek të huaj si gofte skare, quhen njësoj. Nuk është ashtu, në fakt. Edhe ai festival që pamë, ai mbarëkombëtar. Ai kishte vetëm emrin mbarëkombëtar, se po të hysh çfarë kishte brenda, ka shumë probleme. Por kjo është një temë që preka kalimthi jo për ta provokuar. E kam në sensin që kjo konferencë është për shfaqjen e po të futemi në tema të tjera duhen seminare pa fund".

Trebicka tha se kolegëve që kanë

Trebicka: Po vë shfaqje kushdo, ne do shkojmë të bëjmë raki



dashamirësinë për të dëgjuar, e kanë thënë, ndërsa për të tjerë, subjekteve që shohin vetëm veten, s'ke çfarë t'u thuash. "Teatri është teatër. Nuk është çdo lloj gjëje që unë e mendoj se është ashtu e them po bëj teatër. Ajo që është shqetësim është që mungon hierarkia e seleksioni profesional i produktit teatror. Nëse ne hamë fasule përditë, kur të vënë para një gjë tjetër, do thuash ç'është kjo, sill fasulet".

Të pyetur nëse teatri është në krizë, Derhemi tha se "krizë është çështja e institucionit, jo e teatrit në krizë. Institucioni ka probleme të rënda sa u takon njerëzve të cilët e drejtojnë. Ky është problemi i krizës".

Trebicka shtoi se, "kjo sjell kalimin e çdo kujt në skenë. Nuk ka hierarki. Në art ka hierarki vlerash. Që të jem më konkret. Krizimtaria teatrore ka diktaturë

brenda, nuk ka demokraci, në kup-timin që nuk mund të hyjnë të gjithë e ta bëjnë të gjithë. Ka hierarki vlerash, për to le të debatohet, le të ballafaqohet, le të përplasem. Vijnë e ikin si kërpudhat pas shiut. Do vijë ndonjë ditë ndonjë nga Instituti Bujqësor i Kamzës këtu, e unë e Beni do shkojmë të bëjmë raki te vreshtat, a verë. Ka një sens vlera, nuk mund të jetë kështu. E gjithë kjo situatë vjen nga situata rreth e rrotull. Mungojnë shumë gjëra".

Derhemi tha se është një zinxhir që të çon në të njëjtin vend. Trebicka shtoi se çdo shfaqje është sfidë e sprovë dhe se është hulumtuar gjatë për veprën. "Simbolika e metaforat e autorit janë universale. Janë tre vëllezër që përplasem me njëri-tjetrin. Çdo gjë që ndodh në këtë zonë të nxehtë të globit, si Palestina, ai e sjell përmes një familjeje arabe. Flitet shumë për Izraelin, ushtrinë, sigurimin, por ne nuk shohim asnjë izraelit. Përmes arabëve vjen ai gjenocid i gjithë këtyre viteve".

Derhemi shtoi se pjesa u flet jo vetëm vendeve që kanë kaluar luftë. "Publiku shqiptar do e gjejë veten aty dhe do befasonet. Çdo ditë gjatë provave kemi zbuluar gjëra të reja. Shpesh mendojmë se jemi të dashur me njëri-tjetrin, por kur si në veprë futen problematika, njeriu shfaq anën e tij të tmerrshme. Është e rëndë dhe e dhimbshme si histori, e Alfredi tha që publiku duhet të vijë me kova me vete".

Ismail Shino tha se është vëllai i vogël në rol, që përploqet të ruajë njërin vëllai nga akuzat e tjetrit. "Simbolika e mesazhi ynë do të thotë se pushtimi e burgu më i keq është ai i mendjes e shkatërrimi i vlerave e shkatërrimi i dashurisë vëllazërore. Pushtimi arrin të denigrojë shtyllat e shoqërisë, sepse shkon deri në asimilim të njeriut. Shpresoj dhe kam besim që puna jonë do të vlerësohet", shtoi Shino.

Opinion i Ditës

Nga Andon Andoni

(vijon nga faqja 1)

... nga diaspora. Korifenjtë e shkollës shqip, që jetuan dhe punuan jashtë vendit, e sollën gjuhën shqipe jo vetëm në formën e teksteve të leximit, por edhe në metodë, kulturë dhe përmbajtje të barasvlefshme me atë të vendeve më të zhvilluara perëndimore. Në fillim përmes gazetave dhe revistave, pastaj edhe si tekste këndimi dhe historie, maksus për shkollat shqipe të çelura në të gjithë Shqipërinë, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë.

"Pa u druajturë, pa patur frikë se mos lajthitemi, themi se 'kanonizma e shoqërisë të shtypurit shkronja shqip', themeluar në Stamboll më tridhjetë të vjeshtës së parë 1879, ku në fund të kësaj kanonizime shohim në radhura, 28 emra të shoqërisë, ajo shoqëri është shkëndija që ndezi të përhapurit e gjuhës tonë. Ajo shoqëri është shkëndija që i vuri zjarrë përgut q'ish gatiturë që kaqe koh' e tëhu". Do shkruante Lumo Skënderi, alias, Mid'hat Frashëri tek revista "Dituria" që botohe në Selanik në fillim të shekullit. Mund të përmendim edhe të njëzet e tetë burra e shqarë të kombit, pjesë e shoqërisë së Stambollit, që vunë mendjen, zemrën dhe gjithçka të vyer, në shërbim të mësimi të gjuhës sonë. Por të nisur nga mëmëdhetarët e kudo gjendur të diasporës, lista është tejte e gjatë për kornizim e një shkrimi gazete, aq më shumë që në këto radhë nuk kemi synimi këtë gjë.

Ndërsa sot është krejt e kundërta. Sfidat për mësimin e gjuhës dhe kulturës, historisë dhe etnografisë, këngës dhe valles shqiptare, për të cilat ka nevojë komuniteti i shqiptarëve jashtë vendit, që nga vendet fqinje të Ballkanit, nga Amerika, Evropa dhe më pak deri në Lindjen e largët, kalon si valët e ujit, nga mëmëdhetarët drejt skajeve të diasporës. Dhe në dorë këtë gjë nuk

Shqipja në diasporë, pas një shekulli



e kanë me një shoqatë, apo disa individë patriotë, por shteti shqiptar dhe organizmat në nivelet më të larta të përfaqësimit dhe përkujdesjes. Nëse kjo barrë i takonte vetëm një sektori të Ministrisë së Arsimit, madje vite më parë edhe vetëm një punonjësi të saj, sot ka një dikaster të tërë si Ministria e Diasporës që po merret me këtë çështje madhore kombëtare duke përfshirë pikë së pari, mësimin plotësues të shqipes kudo ku jetojnë shqiptarët.

Kështu, nëse dikur, dritë e mësimi të gjuhës dhe historisë sonë erdhi nga shqiptarët e diasporës; nga Stamboll, në Frashërlinjë, Vasën, Jani Vreton, Dervish Himën e Koto Hoxhin; nga Italia e Jugut, me plejadën e arbëreshëve me De Radën në krye, nga arvanitasit me dy Anastasët, Kullurjotin dhe Pigeun; nga Bukureshti dhe Sofja me Naçon dhe Luarasin; nga Vjena me Gjergj Pekmezën; nga Worcesteri dhe Bostoni me Sotir Pecin, Nolin, Konicën, Dakot burrë e grua, Çekrezin e shumë të tjerë, sot ky kapital njerëzor dhe krijes është me të drejtë pronë e shtetit shqiptar, që shkon drejt diasporës, duke i kthyer borxhin e ka hershëm. Sigurisht, që ngre dyflek çështja sa dhe si cilësisht po mbështeten shqiptarët jashtë Shqipërisë dhe fëmijët e tyre të lin-

dur në këto tri dekadat e fundit jashtë atdheut, me mësimin e gjuhës së mëmës, por që kohët e fundit përpjekje janë ngritur në një stad më të lartë dhe cilësor kjo është e prekshe dhe e dukshme.

Nëse njëqind vite të shkuara, "Abetaret u shtypnë dhe u bënë gati të niseshin për Shqipëri. Një copë nga ato i ishte dërguar edhe Sulltanit... Shqiptari kur ja dorëzoi, i tha se ia kishte dërguar si dhuratë shoqëria shqiptare. Sulltani si e pa me vërejtje abetaren duke e shfletuar e pyeti.

- A di t'i këndosh shkronjat e kësaj abetareje?

- Do t'i mësoj në mos ditça, - iu përgjigj shqiptari.

- Të shohim, - shtoi sulltani, - për një javë se cili do këndonjë më mirë, ti apo unë.

Shqiptarët u gëzuan nga fjalët e Sulltanit, por më vonë e kuptuan se cila ishte ajo "dashuri" e madhe që tregonte ay për gjuhën tonë, se pa shkuar shumë kohë, dha urdhër që të mos kalojë, për të shkuar në Shqipëri, asnjë libër shqip".

E sollëm këtë pasazh të së shkuarës, për të paralelizuar me një dukuri të sotme kur shumë prej shkollave të mësimi plotësues, kërkojnë tekste për fëmijët shqiptarë. Vështrësi ka shërish, edhe pse nuk ka më "Sulltanë" që t'i pengojë destinacionin e tyre. Përpjekje

janë bërë edhe në të shkuarën nga Ministria e Arsimit, por cilësia, sasia dhe plotësimi i nevojave me tekste të tilla ka lënë për të dëshiruar. Organizohen çdo vit seminare me mësuesit e shkollave Plotësuese të Gjuhës Shqipe, sa në Shqipëri dhe në Kosovë dhe shumë mirë bëhet, por nga vetë pjesëmarrësit dhe organizatorët, pohohet se ato janë jo të mjaftueshme dhe jo aq efektive dhe dobiprurëse për qëllimin që mbledhen. Çdo shoqatë apo komunitet mësuesish të diasporës deri tani përdorin tekste të ndryshme. Shpesh të hartuara vetë. Nuk po ndalemi tek shumësia e problemeve që kanë mësuesit e shqipes në këto shkolla, pasi ato janë të ndryshme në vende të ndryshme, sipas politikave të ministrive arsimore përkatëse. Kështu për shembull, mbështetja që gjejnë mësuesit e mësimi plotësues, në Suedi, Belgjikë, Gjermani dhe Angli është krejt e ndryshme nga ata që jetojnë dhe punojnë me fëmijët shqiptarë në Greqi. Shkrimi shqip dhe përhapja e dijes, në periudhën e zgjimit kombëtar, u fokusua nën një nacionalizëm romantik, gjë që mendojmë se është e vjetra vijë lidhëse në këtë qasje që po trajtojmë edhe me mendësinë e shqiptarëve të ditëve të sotme. Shkolla shqipe pati nga ata mësonjë patriotë të mërgimit, me karakter të fortë dhe profesionistë të shkëlqyer që nga Sotir Peci, Nego-vanët, Ballkamenët, Luarasët, Dakot dhe deri tek Grigor Cilka, Qirjazat. Ndërsa sot formati i mësuesve të diasporës është një mësuesve emigrant, dhe ndonjëherë edhe pa arsimin e duhur të plotë profesional, por vetëm nga dashuria për dijen kanë çelur shkolla për nxënësit dhe të rinjtë, pas këtyre 27 viteve, kudo ku kanë mundur të sigurojnë tri elemente kryesore, nxënësit frekuentues, mjesdjet dhe tekstet shkollore.

Këto të fundit, tekstet, kanë

qenë dhe mbeten deri në ditët e sotme elementi më deficitar i kësaj trinie.

Që nga abetaret e para, "Ëvetarin" e 1844-ës dhe deri në ditët e sotme abetarja është parë me të drejtë si teksti i parë mësuesor shqip. Ajo u trajtua dhe u pozua nga një numër i madh personalitetesh hartues të saj që nga Naum Veqilharhi dhe deri tek Mimoza Gjokutaj e Shezai Rokaj në ditët e sotme, përfshirë ndërkohë edhe mësues e grup autorësh të arsimit fillor mësues eksperimentues dhe metodistë të talentuar. Nëse të shkuarën, ato u shtypën jashtë që nga Bukureshti, Sofja, Selaniku, Vjena dhe Amerika, dhe shërbyen brenda vendit. Ndërsa sot ato hartohen dhe prodhohen brenda vendit, për t'u shpërndarë në mbarë Evropën e bashkuar e më gjerë në shkollat e Mësimi Plotësues të Gjuhës Shqipe duke pretenduar të jenë pasqyrë e një dinjiteti të lavdërueshëm kombëtar si në përmbajtje edhe në formë.

Abetaret e shekullit të shkuar shërbyen për shkollat njëklasëshe dhe u konceptuan si të tilla. Në to kishte mësim alfabeti, shkronja, zanore, gramatikë, mësim-shkrim, edukate, fe, mësim nga mjedisit fshatar, bujqësia, llogjësia, gjeografia, stinët e vitit, historia me heronjtë tanë Skënderbeun etj.

Në këtë qasje, por tashmë shumë më të plota, moderne në stil dhe në cilësinë, duhet të jenë edhe tekstet e reja të këndimeve për shkollat shqip të diasporës. Specialistët nuk mungojnë për të përcaktuar të tilla me nivel të lartë shkencor, profesional dhe edukativ. Teknologjia për prodhimin e tyre, gjithashtu është e përsosur.

Shumë ujë ka rrjedhur dhe shumë breza shqiptarësh që jetojnë jashtë vendit kanë ndryshuar nga e shkuara deri në ditët e sotme, por misioni i mësimi të gjuhës, kulturës, historisë, letërsisë muzikës dhe gjeografisë sonë ka mbetur po ai. Sfidat ndaj tij, gjithashtu mbeten e njëjtë. Edhe prishtinërit e realizimit të këtij misioni, sot janë më të kapshme dhe më të mëdha.

Le të shprehjemi që ky mision të jetë në udhën e duhur, qoftë edhe sikur të jetë në fillimet e një rrugëtimi të mbarë, profesional, shkencor dhe shoqëror, tashmë nën drejtimin e Ministrisë së Diasporës.

Nga Sejfi Protopapa

Unë kam në dorë gazetën "The Hellenic Voice", që është gazeta në gjuhën angleze me e shpërndarë ndër grekët e Amerikës. Ajo është e datës, 29 prill 2005, ditë e mërkurë, volumni 5, nr. 16. Në faqen e parë të kësaj gazete është artikulli me titullin "Greqia mbas olimpiadës po del përballë një ngritjeje në njerëzit pa strehë dhe në njerëzit e varfër". Artikulli përmban një foto me këtë nënshkrim: "Një njeri pa strehim fle në një stol në qendër të Athinës, janar, 2005. Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e njerëzve pa strehim, por, duke u bazuar në numrin e atyre që janë të strehuar në vende të ndryshme, qyteti i Athinës mendon se ka 9000 njerëz të pastrehuar në tërë Athinën". Lexuesi, ndër "ta edhe unë, është i prekur me këtë varfëri në Greqi dhe ndien një tronditje me qeverinë greke dhe shoqërinë greke, që nuk po përballonjë këtë situatë me të varfir dhe të pastrehuarit në kabinat

Shovinizmi grek shfaqet me hapjen e shkollës greke në Korçë

tyre.

Mirëpo, si kontrast, unë pashë në gazetën shqiptare "Shekulli", më datë 18 prill 2005, një artikull që përshkruante themelimin e një shkolle fillimtare greke në Korçë, të quajtur "Omiros", me qëllim që fëmijët shqiptarë të mësonin të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën greke. Për këtë qëllim ministrja greke e Edukimit, Marietta Gianakou, si edhe zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Evripidis Stilianidis, si përfaqësues të qeverisë greke ishin prezent në ceremoninë për të siguruar shqiptarët se qeveria greke do të financonte dhe do të paguante të gjitha shpenzimet e nevojshme për të mbajtur këtë sh-



kollë greke në Korçë. "Si pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte edhe drejtuesi i Kishës Ortodokse Auto-

qefale të Shqipërisë, Kryepeshkopi Jannullatos. Çfarë drejt lidhje ka një shkolle greke në Korçë me

Kishën Ortodokse Shqiptare? Megjithëse Peshkopi Janullatos përfaqëson një kishë shqiptare, ai paska thënë se ishte shumë i kënaqur të bekonte hapjen e kësaj shkolle. Përsa i përket bekimit të shkollës, do të ishte shumë lehtë që këtë ceremoni ta bënte një prift lokal, ose vetë peshkopi i Kishës Ortodokse të Korçës, Imzot Jani. Mirëpo peshkopi Janullatos dëshiron t'u thotë shqiptarëve që në të vërtetë ai nuk çan kokën për Ortodoksinë Shqiptare. Ai po u thotë shqiptarëve se prezenca e tij në atë ceremoni duhet t'iu mbushë mendjen shqiptarëve si një provë që ai është i interesuar vetëm në shpërndarjen e helenizmit në Shqipëri).

Opinion i Ditës

Arabia Saudite, miliona USD për të ndikuar në Kongresin Amerikan

Zëri i Amerikës

(vijon nga faqja 1)

... fillimin e vitit 2017, në kuadër të një operacioni të gjerë ndikimi për të zbutur qëndrimet anti-saudite në Kongres dhe për të nxitur interesat e tjera saudite në Shtetet e Bashkuara, thuhet në një studim të ri, bazuar në regjistrin federal amerikan për lobizim.

Analizimi i të dhënave nga Akti i Regjistrimit të Agjentëve të Huaj për vitin 2017 nga Qendra për Politika Ndërkombëtare, gjeti se ndërsa 25 për qind e fondeve u ishin dhënë Komisioneve për Veprim Politik (PAC - organizata private që grumbullojnë dhe shpenzojnë fonde për fushata elektorale), më shumë se 1.5 milionë dollarë u përdorën për fushata elektorale individuale, me afro 400 mijë dollarë të dhëna për 75 anëtarë të Kongresit, të cilët u kontaktuan nga lobistët në emër të Arabisë Saudite.

Mes ligjvënësve, Kevin McCarthy, udhëheqësi i shumicës republikane në Dhomën e Përfaqësuesve, ishte përfituesi më i madh i donacioneve të fushatës nga lobistët në emrin e sauditëve dhe Senatori Bill Nelson, ishte përfituesi kryesor nga krahuri i demokratëve.

Në 12 raste, anëtarë republikanë dhe demokratë, kanë marrë kontribute për fushatat e tyre në të njëjtën ditë, që zyrat e tyre ishin kontaktuar nga lobistët të sauditëve, që në shumë raste kishin lidhje me projektligjin për të lejuar viktimat e sulmeve të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara që të hidhnin në gjyq Arabinë Saudite.



Mes këtyre ligjvënësve janë republikani Bob Corker, Kryetar i Komisionit të Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë; republikani Richard Burr, që drejton Komisionin e Senatit për Zbulimin; demokratit Cedric Richmond që drejton grupin e ligjvënësve afrikanë-amerikanë në Dhomën e Përfaqësuesve.

"Në hulumtimet tona gjetëm se lobistët për sauditë bënë përpjekje të vazhdueshme në vitin 2017... dhe mendja ta do, që ata po bëjnë të njëjtën gjë tani", tha Ben Freeman, që drejton Nismën për Transparençen e Ndikimit të Huaj dhe njëkohësisht autor i raportit.

Kontributet për fushata elektorale janë të lejuara. Ligjet në Shtetet e Bashkuara lejojnë që amerikanët të lobojnë në emër të qeverive të huaja dhe të japin kontribute financiare për fushatat e ligjvënësve, për sa kohë që aktivitetet e tyre dhe donacionet financiare raportohen pranë Departamentit të Drejtësisë.

Lydia Dennet, eksperte me Projektin për Mbikëqyrjen e Qeverisë

në Uashington, thotë se ndërsa raporti të jep përshlypjen e një shkëmbimi të drejtpërdrejt favorësh, mes lobistëve dhe ligjvënësve, ai nuk sugjeron se "ata po veprojnë si përçues të një qeverie të huaj".

"Shpesh këta njerëz veprojnë në kapacitetet e tyre personale ndaj është shumë e vështirë të thuhet nëse janë veçanërisht të motivuar politikisht ose nëse kanë marrëdhënie personale me individin në emër të të cilit dhurojnë para", tha zonja Dennet.

Zyrtarët në ambasadën e Arabisë Saudite në Uashington ende nuk kanë i janë përgjigjur kërkesës së Zërit të Amerikës për të komentuar mbi këtë çështje.

Raporti në fjalë vjen ndërsa janë shtuar zërat që dënojnë vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi më 2 tetor në konsullatën saudite në Stamboll. Zyrtarët sauditë kanë thënë se vrasje ishte kryer nga disa agjentë që vepruan me kokë të tyre, por kritikët e akuzojnë Arabinë Saudite se po gënjën mbi rolin e saj në vrasjen brutale.

Është e qartë se këto dy ngjarje tregojnë se udhëheqësit grekë janë me dy mendje në kundërshtim me njëra-tjetrën. Pozita e qeverisë greke duket sikur thotë: harroi grekët që janë të varfër dhe pa strehim. Fundi i fundit, ata janë vetëm grekë fatkeq dhe ndoshta grekë pa vlerë. Përse të bëhet merak për ta qeveria greke? Ata janë qytetarë grekë të zotë të rregullojnë jetën e tyre. Si duket, udhëheqësit grekë nuk kanë dëgjuar gjë për revolucionin francez dhe të gjitha revolucionet që e vazhduan atë, zhvilluar me qëllim që të bindej qeveria e vendit t'i trajtonte të varfërit si qytetarë të barabartë dhe se ata kishin nevojë për ndihmë nitëse, kështu që edhe ata të merrnin pjesë në zhvillimin e vendit të tyre. Për të korrigjuar konsekuencat e depresionit i gjatë 1930-tave në Shtetet e Bashkuara, presidenti Rosvelt filloi procesin sosiopolitik, i cili vazhdon edhe sot, që e detyron qeverinë që të ndihmojë të varfërit e vendit. Si parim, qeveria duhet të sigurojë që të gjithë qytetarët të kenë ushqim dhe strehim. Jo. Udhëheqësit grekë janë të vendosur ta bëjnë Korçën një zonë greke përdorur çdo

mjet që mund t'u ndihmojë për atë qëllim.

Në fillim, ata menduan se të gjithë shqiptarët ortodoksë ishin grekë. Për të mbrojtur ortodoksitë e Shqipërisë, grekët përkrahen ardhjen e peshkopit Janullatos në Shqipëri për të drejtuar Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Njëkohësisht, ata filluan të numërojnë sa etnikë grekë ishin në Shqipëri. Çdo herë dilnin me një numër të vogël, disa dhjetëra-mijëra grekë, të cilët banonin në fshatrat afër Gjirokastrës dhe Sarandës. Në Korçë, ata nuk gjenin dot shumë grekë. Grekët zbuluan se në Korçë kishte vetëm ortodoksë shqiptarë të sinqertë, të cilët ishte e qartë se nuk ishin grekë. Kështu pra, ndonjë gjëni grek sugjeroi idenë që qeveria greke duhej të harronte të pastrehuarit dhe të varfërit. Përkundrazi, ato para duhej të shpenzoheshin në Korçë për të ndërtuar shkolla greke, ku fëmijët shqiptarë do të mësonin gjuhën greke si edhe një sasi kulturore greke. Qëllimi do të ishte që më vonë këta fëmijë vullnetarisht do të deklarorin se ishin nënshtetas grekë. Gomarllëk i madh ky mendimi grek. Shqiptarët kanë mësuar

të mbijetojnë në shumë forma të ndryshme asimilimi të përdorura për nënshtetimin e vendit të tyre nga të huajt. Një shembull klasik për asimilimin është imperatoria Otomane. Ata patën sukses që të kthejnë një shumicë shqiptarësh në fenë myslimane, por kur erdhi koha, ata myslimanë u bënë armiq të më fanatikë të qeverisë turke. Ata u ngritën së bashku me vëllezërit e tyre të të krishterë dhe luftuan për lirinë dhe pavarësinë e tyre nga nënshtetimi i huaj.

Grekëve të sëmurë dhe shovinistë, unë ju them: Ndaloni këtë çmendri. Hiqni dorë nga çmenditë dhe manite tuaja. Zgjuhuini nga gjumi dhe shikoni rreth e rrotull. Evropa është duke përmirësuar gjithmonë formën e qeverisjes. Shejpt a vonë, Shqipëria do të anëtarësohet në komunitetin evropian. Atëherë, shqiptarët dhe grekët, si qytetarë të barabartë të Evropës, mund të zgjedhin të jetojnë ku të duan në Evropë dhe do të jenë një herë e përgjithmonë të lirë nga çdo formë nacionalizmi të sëmurë.

*** Artikulli u publikua në maj 2005**

Katër firma amerikane lobimi tashmë kanë ndërprerë punën për Arabinë Saudite, ndërsa një kompani tjetër e ka shtuar këtë vend si klient të saj. Në tërësi, më shumë se 20 kompani amerikane lobimi, apo të marrëdhënieve me publikun aktualisht e kanë Arabinë Saudite si kliente. Vitin e kaluar, mbretëria saudite shpenzoi më shumë se 27 milionë dollarë në përpjekjet për lobim në Shtetet e Bashkuara.

"Nëse gjetjet në këtë raport shërbejnë si tregues, lobistët për Arabinë Saudite në Uashington ka gjasa që janë duke kontaktuar me ngulm zyrat e kongresit për të penguar miratimin e ligjeve që do të ndëshkonin Arabinë Saudite për veprimet e tyre dhe ndoshta ata po japin kontribute për fushatat e të njëjtëve ligjvënës", thuhet në raport.

Sipas raportit, vitin e kaluar 29 firma dhe individë u regjistruan në bazë të Aktit për Regjistrimin e Agjentëve të Huaj, (FARA) për të përfaqësuar Arabinë Saudite duke listuar më shumë se 2,500 kontakte politike në vend. Aktivitet, që nga kontaktimi i ligjvënësve amerikanë e deri tek lidhjet me median për të ndikuar për një frymë pozitive pro-saudite, u ndërmorën nga më shumë se 100 individë që punonin për këto firma, thuhet në raport.

Senati ishte institucioni më i kontaktuar pasur nga mediat, Dhoma e Përfaqësuesve dhe Dega Ekzekutive. Zyrat e Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve u kontaktuan gjithsej 1,409 herë, afro tri herë për çdo anëtar. Përpjekjet e lobizmit në Kongres u drejtuan kryesisht ndaj udhëheqësve partiakë dhe pjesëtarëve në komisione të rëndësishme si Komisioni i Senatit për Marrëdhënie me Jashtë, thuhet në raport.

Senatori republikan Lindsey Graham, i cili shërben në Komisionin e Senatit për Forcat e Armatosura dhe ka dalë si kritik i vendosur ndaj Arabisë Saudite pas vrasjes së gazetarit Khashoggi, ishte ndër ligjvënësit më të kontaktuar. Raporti thotë se zyra e tij ishte kontaktuar 36 herë. Mes demokratëve, Chris Coons, anëtar i Komisionit të Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë ishte më i kontaktuar nga lobistët. Zyra e tij ishte kontaktuar 33 herë.

Përmes fushatës së jashtëzakonshme të lobimit dhe marrëdhënieve me publikun, Arabia Saudite është përpjekur të bllokoi Aktin Drejtësi Kundër Mbështetësve të Terrorizmit (JASTA) dhe i është kundërvënë kritikave ndaj luftës që po zhvilloh në Jemen, bllokadës ndaj Katarit, goditjes së diskutueshme ndaj korrupsionit dhe përpjekjeve për të bllokuar shitjen e raketave amerikanë për Riadin.

Raporti thekson se arsytet më të cituara për kontaktimin e zyrave të kongresit ishin JASTA, Jemeni, Katarit dhe shitja e armëve.

HOROSKOPI

DASHI

Nuk do të mungojnë idetë e reja dhe energjia e duhur për t'i zbatuar projektet tuaja. Do të kenë mbështetjen e një mikut të ngushtë në çështjen e parave. Sa i përket dashurisë, mund të bëni një lidhje të re.

DEMI

Keni nevojë për më shumë frymëzim në jetën profesionale. Duket se ju mungon dëshira për punë. Mos e fajësoni veten, se kjo është një gjendje normale. Jepini jetës suaj më shumë ngjyra.

BINJAKET

Do të jeni mjaft të angazhuar më punë, duke lënë disi pas dore familjen. Shikoni vetëm anëtarë pozitivë të gjërave sot, duke lënë mënjanë keqkuptimet. Paratë nuk do ju mungojnë, por edhe shpenzimet do të jenë të shumta.

GAFORJA

Lajme të mira mund të merrni sot në punë. Një rritje në detyrë do t'ju bëjë shumë të gëzuar. Energia pozitive do të pasqyrohet edhe në marrëdhënien tuaj me miqtë, të cilët do ndihen mirë në praninë tuaj.

LUANI

Përgjithësisht keni dëshirë të bëni shaka, por nuk i prisni mirë ato kur bëhen nga të tjerët. Tregohuni më tolerant ndaj njerëzve që ju rethojnë. Sa i përket dashurisë, ende nuk do e cin gjërat siç duhet.

VIRGJERESHA

Do të merrni lajme të mira nga një investim që keni kryer disa vite më parë. Edhe pse i kishit humbur shpresat, aspekti planetar do jetë pozitiv për ju. Ditë jo shumë e konsoliduar sa u përket financave.

PESHORJA

Do të ndjeni se gjërat nuk po shkojnë sipas planit. Kjo periudhë do të jetë kalimtare, sepse shumë shpejt suksesi do të jetë në anën tuaj. Ditë jo shumë e konsoliduar sa u përket financave.

AKREPI

Marrëdhënia juaj me partnerin do të ketë ulje- ngritje sot. Në momentin kur do të mendoni se jeni e plotësuar, mund të shkrepin debatet. Gjithsesi, çdo diskutim ju ndihmon për të sqaruar mosmarrëveshjet.

SHIGJETARI

Nëse keni nevojë që të ndryshoni ambient, bëjeni këtë. Do të shihni se do të ndiheni më mirë. Lajme të mira parashikohen në aspektin profesional. Opinione pozitive mund të kenë eprorët për punën tuaj.

BRICJAPI

Një raport i ri dashuror duket në sfond për të lindurit në shenjin tuaj. Është me rëndësi që të lini një përshlypje të mirë të partneri. Në punë dikush mund të përpiqet t'ju nxjerrë pengesa.

UJORI

Një fillim i ri duket shumë pranë. Ky fillim i ri mund të jetë në punë, në një biznes apo dashuri. Një propozim për punë duhet ta vlerësoni me shumë kujdes, sepse mund të rezultojë një dështim.

PESHQIT

Aktualisht ndiheni i pakënaqur me rezultatat në punë. Mos hiqni dorë, sepse sot jvet ju favorizojnë. Në aspektin e dashurisë gjithashtu gjërat mund të ecin mjaft mirë për ju. Një njoftje e re mund t'ju gëzojë maksimalisht.

Tension dhe frikë. Gjatë ndeshjeve të Grupit H në Europa League, ka pasur probleme me tifozët. Tifozët e Lacios kanë rënë pre e agresionit të tifozëve kundërshtarë si në transfertën e Frankfurit, ashtu edhe në atë të Marsejës. Në Gjermani, ultrasit e Ajntrahtit i kërkonin tifozët e



Në prag të ndeshjes Lacio-Ajntraht Frankfurt

Frikë nga fashistët, presidenti i Ajntrahtit u kërkon tifozëve të rrinë në shtëpi

Lacios deri në hyrjet e hoteleve ku ata ishin akomoduar, apo në restorantet ku ishin ulur. Edhe në Francë ka pasur një ndjekje të tifozëve italianë kudo ku ata ishin. Gjatë ndeshjes Eintraht-Apollon Limasol, policia gjermane ka boshatisur sektorin e tifozëve miq dhe ka arrestuar tre prej tyre, madje edhe një minorene, pasi mbanin fanella me nuanca naziste. Për këto arsye, presidenti i Ajntrahtit të Frankfurtit ka bërë apel që tifozët e skuadrës së tij të mos shkojnë në Romë për të ndjekur ndeshjen me Lacion, por ta shohin ata nga televizori. Kjo ndeshje luhet më 13 dhjetor dhe për momentin janë 5800 bileta

në dispozicion të tifozëve gjermanë dhe për këtë presidenti Fisher është i shqetësuar: "Kam frikë se në Romë do të shkojnë edhe tifozë, të cilët nuk do të kenë bileta. Qëndroni në shtëpi dhe shikojni ndeshjen në televizor. Në Romë ka grupe ekstremistësh, janë të ashpër dhe vështirë të menaxhohen", - ka thënë ai.

"Një grek më pak, një bastard më pak", i kushton rëndë klubit të kuq, që pritet të apelojë vendimin

Parulla anti-greke, Partizani 2 ndeshje pa tifozë

Gjoha për Skënderbeun, Tiranën dhe Flamurtarin



Jeton Selimi

Ashtu siç pritej, Komisioni i Disiplinës në Federatën Shqiptare të Futbollit, ka vendosur të dënojë Partizanin me dy ndeshje pezullim, për shkak të parullës së shpalosur nga disa tifozë gjatë ndeshjes Partizani-Skënderbeu, e cila u fitua me rezultatin 2-0 nga korçarët. "Një grek më pak, një bastard më pak" ishte mesazhi i shkruar në parullë, mesazh që krijoi konfuzion dhe jehonë të madhe nga politikanët shqiptarë dhe ata grekë. Mediat helene u morën gjerë e gjatë me këtë parullë për shkak të ekzekutimit të terroristit Kostantinos Kaçifas, autor i një sulmit me armë ndaj policisë shqiptare në fshatin Bularat. Kryeministri i Rama apo edhe presidenti Meta dënuan mesazhin, që më herët ishte dënuar nga vetë klubi i kuq dhe tifozëria e organizuar e Partizanit. "KF "Partizani", për sjellje të gabuar të spektatorëve duke hedhur sendeve të forta brenda rre-




thimit të fushës se lojës dhe për paraqitje të parullave fyese dhe raciste, në bazë të

nenit 66/3/a të KDS, dënohet me zhvillimin e 2(dy) ndeshjeve pa spektatorë në

fushën përkatëse, "shkruhet në njoftimin e publikuar ditën e djeshme nga federa-

ta, e cila e kishte paralajmëruar këtë ndëshkim një natë më parë nëpërmjet një qëndrimi zyrtar. Gjithsesi, Partizani pritet ta apelojë këtë vendim, pasi nga të gjithë, madje edhe nga vetë FSHF, rasti është cilësuar si i izoluar. Ndërkohë vendime të tjera për klube të tjerë. Kështu, Skënderbeu, Tirana dhe Flamurtari janë ndëshkuar me gjobë për sjellje të gabuar të tifozëve, gjobë e cila është e njëjtë për të tri klubet, 50 mijë lekë të rinj. Nuk ka shpëtuar pa u lagur as mesfushori i Flamurtarit, Idriz Batha, që dënohet me një ndeshje pezullim për lojë të rëndë ndaj kundërshtarit, gjest që u përfol shumë si një vendim i gabuar i gjyqtarit Hamiti, që e la pa ndëshkuar Bathën në takimin Flamurtari-Teuta.

YLLI ARGJENTINAS



Mesi lë pas dëmtimin, gati për Barcelonën

Lionel Mesi u kthye në stërvitje më herët se sa pritej me Barcelonën, ku vazhdon rikuperimin e tij nga një dëmtim në krah, që e mbajti jashtë fushave kundër Interit dhe Real Madrid javën e kaluar. Ylli argjentinasi parashikohet të qëndronte jashtë fushave për tri javë, pasi kishte thyer një kockë në krahun e djathtë më 20 tetor gjatë ndeshjes kundër Sevilyës, por mediat në Spanjë sugjerojnë se Mesi mund të jetë në dispozicion të ekipit më shpejt se parashikohet. Mesi, i cili nuk është përfshirë në skuadrën për ndeshjen e Barcelonës në "Copa del Rey" kundër Kultural Leonesa, nuk do të luajë as të shtunën në La Liga kundër Rajo Vahekanos. Megjithatë, Mesi pritet të jetë në fushë kur Barcelona përballlet me Interin më 9 nëntor. Sipas "Calciomercato", Mesi po bën të pamundurën që të rikthehet në ndeshjen e Ligës së Kampionëve, por vendimi i takon vetëm Valverdes, i cili me shumë gjasë do ta ruajë për ndeshjen kundër Atletico Madridit pas pshimit për shkak të

Divorci duket i pashmangshëm në janar

Kukësi ndëshkon Arbër Çyrbjen, e çon tek ekipi B

Arbër Çyrbja, ish-kapiteni i Teutës, ra në sy sezoni në kaluar me lojën e tij dhe në merkaton e verës Kukësi vendosi ta afronte në ekip, por në asnjë moment futbollisti durrsak nuk ka mundur të shfaqë të njëjtat vlera edhe me fanellën e veriorëve. Por së fundi duket se ka lindur edhe një konflikt mes lojtarit dhe drejtuesve të Kukësit, ku këta të fundit kanë vendosur ta çojnë Çyrbjen te Kukësi B. Lajmi është konfirmuar nga burime të "Vipsport.al" pranë klubit kukësitian. Durrsaku është bindur dhe ka pranuar të stërvitet me skuadrën e dytë të Kukësit, por mbetet të shihet si do të rrjedhin ngjarjet, nëse lojtari do të kthehet me skuadrën e parë, apo do të kemi një ndarje përfundimtare të tij me Kukësin në merkaton e dimrit. Gjatë ndeshjeve të fundit Çyrbja është aktivizuar pak ose aspak në formacionin e trajnerit Cungu, i cili ka preferuar Valon Ethemin në krahun e djathtë të mesfushës. Ndoshta drejtuesit e Kukësit prisnin më shumë nga Çyrbja dhe janë të zhgënjyer nga paraqitja e tij e deritanishme.

Zhvillime të reja në futboll


FIFA gati ta zgjerojë me 48 skuadra botërorin e Katarit

Xhani Infantino po përpjehet në çdo mënyrë të mundshme që të gjejë mbështetjen për rizgjedhjen si president i FIFA-s dhe pjesë e planit të tij është të afroje aplikimin e ndryshimit të skemës për zhvillimin e Botërorit, duke rritur numrin e pjesëmarrësve nga 32 ekupe, në 48 që në edicionin e ardhshëm. "Kemi vendosur të rritim numrin e skuadrave pjesëmarrëse, vendim që do të hyjë në fuqi në vitin 2026. A mund të ndodhë që në vitin 2022? Është e mundur, përse jo? Po diskutojmë me miqtë tanë në Katar dhe urojmë që të bëhet e mundur.

Gjithçka do të vendoset përfundimisht në fillimin e vitit të ardhshëm, para fillimit të kualifikueseve", tha ai para asamblesë së AFC, Konfederatës Aziatike të futbollit. Infantino mendon se në këtë mënyrë do të ketë mbështetje më të gjerë nga Azia dhe Afrika, konfederatat e cilave kanë më shumë vota në kongresin e FIFA-s dhe nuk është rastësi që këto kontinente janë ato që përfitojnë më shumë nga rritja e numrit të skuadrave pjesëmarrëse në Botëror. Përkundër asaj që mund të mendohet, rritja për Eu-

ropën do të jetë minimale, vetëm 3 vende më shumë, nga 13 të skemës aktuale në 16. Ndaj shanset për Shqipërisë, siç mund të trumbetohet lart e poshtë, nuk është se shtohen edhe aq shumë. Në fund të fundit, duhet si në të kaluarën që biletën për në Botëror kuqezinjët ta presin duke dalë në një prej dy vendeve të para në grup. Duke u nisur nga vazo e katërt apo e pestë mes të cilave luhatet aktualisht, shanset për ta bërë një gjë të tillë janë me të vërtetë minimale.

Fjalëkryqi (1)



- 36. Louis, poet surrealist.
- 38. Artet pa re.
- 39. Matet pa kufij.
- 40. Gruaja e Ben Hur.
- 42. Liam i Schindler's list.
- 45. Të parat në orkestër.
- 47. Makina Ibiza.
- 48. Renato, piktor i famshëm italian.
- 49. Mihali këngëtare lirike.

VERTIKAL

- 1. Mbyllin fushata.
- 2. Një pjesë e pikturave.
- 3. Janë njëvjeçarë
- 4. Një ngjyhet në tavolocë.
- 5. Është katolik ai i papës.
- 6. Mbyllin portat.
- 7. Opera e Mascagni-t.
- 8. Tregohet duke bërë masakra.
- 10. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- 11. Një gjuajtës francez.
- 12. Është porti i Durrësit.
- 13. Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
- 16. Pak pirograf.
- 19. Një pjesë e aerobisë.
- 21. U vodhi zjarin perëndive.
- 22. Premtojnë të bëhen asa.
- 23. Mbeten në fund.
- 26. Rreth pa ekstreme.
- 28. Rendi pa zë
- 29. Është veshje tahitianësh.
- 30. Tase e volejbollit.
- 33. Është shahu i fundit.
- 34. Kim... Stuart aktor.
- 35. Fritz regjisori.
- 37. Ai i shtatë është kinemaja.
- 39. Një pjesë e ansambllit.
- 41. Diftong teatral.
- 43. Të parat në stacion
- 44. Qendër në tour
- 46. Mbarojnë fare.

HORIZONTAL

- 1. Me të nxjerrin një tapë.
- 4. Inicialet e Klee piktor.
- 6. Qiriaçi aktor.
- 9. Etikë pa kufij.
- 11. Merren për shembull.
- 14. Fund janari.
- 15. Janë edhe ata të skuadrës.
- 17. Ortolani kompozitor.
- 18. Ushtrohej edhe nga bukanierët.
- 20. Në krye të sondazheve.
- 21. Janë të ndaluar në kthesë.
- 23. Ente Rajonale Civile.
- 24. Gjermania në tabela.
- 25. Mund të jetë unik.
- 27. Philippe që qe aktor.
- 29. Një pjesë e pelegrinazhit.
- 31. Gjysmë leader.
- 32. Maten pa zë.
- 33. Janë të përpjeta.
- 35. Qytet anglez.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Harris aktor.
- 3. Termocentrali i shkurtër.
- 5. Organizata me koska.
- 10. Një tufë bagëtish.
- 12. Inicialet e Redford.
- 14. Kështu thonë se bëhet ai që mërziut.
- 15. Scarlet e Bashkë e erën.
- 17. Elvira aktore.
- 19. Është Panorama që ke në dorë.
- 21. Ushtojnë nga "ola".
- 22. Shtet aziatik.
- 24. Është ministri.
- 25. Në radhtë të parë.
- 26. G... për njerëzit e FBI.
- 27. Makina Micra.
- 31. Mund të jetë proteste.
- 32. Pasur pa kufij.
- 33. Gjika e Dora d'Istria.
- 36. Të fundit në dhjetor.

VERTIKAL


- 1. Umberto që shkroi Baudolino.
- 2. Bertë këngëtare italiane.
- 3. Fillojnë një temë.
- 4. Një garë në hipodrom.
- 6. Qe burri i parë.
- 7. Një ndriçues.
- 8. Bëjnë shirit me shi.
- 9. I dha fillin Tezaut.
- 10. Vihen për të mbyllur
- 11. Para Saint-Germain në futboll.
- 13. Qëllojnë në një vend.
- 16. Është dosja e të pandehurit.
- 17. Janë përmasat.
- 18. Mbush në kufij.
- 20. I bëjnë duart me ar.
- 21. Inicialet e dali piktor.
- 23. Fillojnë argumentin.
- 28. Makina Ibiza.
- 29. Emri i Einstein.
- 30. Ndriçojnë rrugët.
- 31. Kim që qe aktore.
- 32. I hedh i dorzuar.
- 34. Inicialet e Nolte aktor.
- 35. Ishin rapsodët e akeje.
- 37. Fund shkurti.
- 40. Van der portier holandez.
- 44. Fillojnë masat
- 46. Inicialet e Rohmer.
- 47. Fillojnë teorikisht.
- 49. Numëri i shkurtër.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8	3		2	1	7			4	
4	6		8					7	2
	9				6				3
		2	4	6	3				
					9				
3	7				4	1			
2	8				5	4	9		
5		9				6			
6	1				8		2		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	1	4	7	2	5	8	3	6
5	2	6	9	3	8	7	4	1
3	7	8	6	1	4	5	9	2
7	4	1	5	9	2	3	6	8
6	9	5	3	8	1	2	7	4
8	3	2	4	6	7	9	1	5
1	5	9	8	7	6	4	2	3
2	8	3	1	4	9	6	5	7
4	6	7	2	5	3	1	8	9

Argëtim filozofik

- Karakteristikat e vërteta të injorancës janë kotësia, krenaria dhe arroganca (Samuel Butler)
- Informacioni nuk është njohuri (Albert Einstein)
- Dikush mund të buzëqesh dhe të jetë djall (William Shakespeare)
- Pasioni për të mësurar... është një për mbijetesë (Carl Sagan)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	P	U	6	S	1	I	15	2	3		5	7	3	S	T	A	R	E	T	I	K	E	T	A	T	
2	4	8				4	7		8	6		9	1		A	R	M	I	K	S	T	O	L	I	T	E
6	1		3	10	9	10	4	1	11	8	5				L	I	O	R	O	M	I	N	A	T		
12		3	8	11	7	4	8	13	8		5				L	O	C	A	B	A	R	E	T	L	A	
5	4	1	3	8	11	7	16	7	13	8					A	B	A	T	E	R	I	T	E	A	R	
10		3	8	5	8	5	1	11	8	5					T	R	I	M	E	R	I	T	E	A	N	E
5		10	6	8		1	5	5	7	18					A	R	T	U	R	O	U	I	M	A	T	T
1	8	4			3	4	8	11	1	13	10				A	R	S	E	N	E	A	A				
4	1	17	12	8	10	4		6	1	9					A	D	A	T	M	E	T	R	I	C		
6	5	1	9	10	5		10		2	15	10				P	A	K	T	P	I	R	A	T	E	R	I
4	2	16			5		2	15	10						K	U	A	L	I	T	E	T	I	E	P	
4	1	17	12	8	4	18		5	8						L	E	C	E	P	I	N	A	T	A		

Thënie të mençura

- Për ta gjetur vetveten, mendoni për vetveten (Sokrati).
- -Idioti flet për ate që do të veproj.....
- Egoisti flet për ate që ka vepruar.....
- Kurse inteligjenti vepron e nuk flet.....
- -Ne jete njerzit ju ngjajne fjaleve: nese nuk i vë ne vendin e vet, e humbin kuptimin
- -Jeta eshte si një monedhe! Ne njerin ane ndodhet dhimbja dhe ne anen tjeter lumturia. Ti mund te shohesh vetem njerin ane, por mos harro, edhe ana tjeter e ka radhen e saj

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

